

TITULL I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Subjekti

1. Kjo Rregullore përcakton një kod rrjeti i cili parashton kërkesat për lidhjen me rrjetin të:
 - a) objekteve të kërkesës që lidhen në transmetim;
 - b) objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim;
 - c) sistemet e shpërndarjes, përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes;
 - d) njesitë e kërkesës të përdorura nga një objekt kërkesë ose sistem të mbyllur shpërndarje për të siguruar shërbimet e përgjigjes së kërkesës për operatorin respektiv dhe OST-te respektive.
2. Kjo rregullore, pra, ndihmon për të siguruar kushte të barabarta konkurrence në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, për të siguruar sigurinë e sistemit dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike, si dhe për të lehtësuar tregtinë e energjisë elektrike në mbarë Unionin.
3. Kjo Rregullore gjithashtu përcakton detyrimin për tu siguruar që Operatorët e sistemit përdorin sic duhet aftësitë e objekteve të kërkesës dhe të "sistemeve të shpërndarjes" në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese për të siguruar një fushë loje të barabartë në të gjithë Unionin.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet në nenin 2 të Direktivës 2012/27 / EU3, Nenin 2 të Rregullores (KE) Nr 714/2009, Nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/12224, Nenit 2 Rregullores së Komisionit (EU) [000/2014 - RFG], Nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) Nr 543/20135 dhe të nenit 2 të Direktivës 2009/72 / EC.

Përveç tyre, do të zbatohen dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. 'objekt kërkesë' është një objekt i cili konsumon energji elektrike dhe është i lidhur në një ose me shumë pika lidhje me sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes. Një sistem

shpërndarës dhe / ose pajisjet ndihmëse të një moduli gjeneruese nuk përbëjnë një strukturë të kërkesës.

2. 'objekt kerkese i lidhur ne transmetim' eshte nje objekt kerkese i cili ka pike lidhje ne nje sistemi transmetimi;

3. 'objekt i shperndarjes i lidhur ne transmetim' eshte lidhja e sistemit të shpërndarjes ose centrali elektrik dhe pajisjet e përdorura në lidhjen me sistemin e transmetimit;

4. "njësi kërkesë" eshte grup i pandashëm i instalimeve qe përmban paisjet qe mund te kontrollohen nga ana e pronarit të objektit te kërkesës ose nga nje CDSO, ose individualisht ose bashkërisht si pjese te agregimit te kërkesës nëpërmjet nje pale te trete;

5. 'Sistemi i mbyllur i shpërndarjes' eshte nje sistem shpërndarje i klasifikuar ne përputhje me Nenin 28 te Direktives 2009/72/EC si sistem i mbyllur shpërndarje nga autoritetet rregullatore ose nga autoritetet e tjera kopetente, kur parashikohet nga Pala Kontraktuese, i cili shpërndan energji brenda nje zone industriale tregetare ose te shërbimeve te perbashketa , i izoluar gjeografikisht , dhe që nuk furnizon konsumatorët familjare, pa përjashtuar rastet e përdorimit nga një numër i vogël i familjareve të vendosura brenda zonës te shërbyer nga sistemi dhe me punësim ose lidhje shoqerore te ngjashme me pronarin e sistemit;

6. 'paisja kryesore e kërkesës' eshte se paku nje nga paisjet e meposhtme; motorët,transformatorët,paisjet e tensionit te larte ne pikat e lidhjes dhe ne procesin e prodhimit te centralit;

7. 'sistemi i shpërndarjes i lidhur ne transmetim' eshte nje sistem shpërndarje i lidhur ne sistemin e transmetimit , perfshire objektet e shpërndarjes te lidhur ne transmetim;

8. 'aftesia maksimale e importit' eshte fuqia aktive maksimale e vazhdueshme qe nje objekt kërkesë i lidhur ne transmetim ose objekt shpërndarje i lidhur ne transmetim mund te konsumoje nga rrjeti ne piken e lidhjes, sic specifikohet ne marrëveshjen e lidhjes ose sic dakordohet ndërmjet operatorit respektiv dhe pronarit te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose te operatorit te sistemit te shpërndarjes respektiv te lidhur ne transmetim;

9. 'aftesia maksimale e eksportit' eshte fuqia aktive maksimale e vazhdueshme qe nje objekt i kërkesës i lidhur ne transmetim ose objekt shpërndarje i lidhur ne transmetim , që mund te ushqeje rrjetin ne piken e lidhjes, sic specifikohet ne marrëveshjen e lidhjes ose sic dakordohet ndërmjet operatorit respektiv dhe pronarit te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose te operatorit te sistemit te shpërndarjes respektiv te lidhur ne transmetim;

10. 'çkycja e kërkesës nga ulja e frekuencës ' nënkupton veprimin kur kërkesa çkycet gjate ngjarjes se rënies se frekuencës me qellim qe te mbulojë balancën ndërmjet kërkesës dhe gjenerimit dhe rivendose frekuencën e sistemit ne kufinj te pranueshëm;

11. 'çkycja e kërkesës nga rënia e tensionit' nënkupton veprimin e restaurimit ku kërkesa çkycet gjate ngjarjes se rënies se tensionit me qëllim qe te riktheje tensionin ne kufinjte te pranueshëm;
12. 'rregullatori I degezimeve ne ngarkese ' do te thote nje paisje per ndryshimin e pozicionit të pëshjellave ,i pershtatshem per operim nderkohe qe transformatori eshte I energjizuar ose ne ngarkese;
13. 'bllokimi I rregullatorit te degezimeve ne ngarkese' do te thote veprimi qe bllokon rregullatorin e degezimeve ne ngarkese gjate nje ngjarje te nen-tensionit me qëllim qe te ndalohet ne transformoret renia e metejshme të tensionit ne nje zone;
14. 'dhoma e kontrollit' eshte qendra e operimit respektive e operatoreve te sistemit;
15. "ngarkesa e bllokut" do te thote hapat maksimal te ngarkeses se fuqise aktive te kerkeses se rilidhur gjate rivendosjes se sistemiit pas black-out-it ;
16. 'pergjigja e kërkesës kundrejt kontrollit te fuqisë aktive" eshte kërkesa brenda nje objekti kerkese ose sistemi te mbyllur shpërndarje qe eshte e disponueshme per modulim nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive, e cila rezulton ne modifikimin e fuqisë aktive;
17. 'përgjigja e kërkesës kundrejt kontrollit te fuqisë reaktive' eshte fuqia reaktive ose paisjet kompensuese ne nje objekt kerkese ose sistem te mbyllur shpërndarje qe jane te disponueshme per modulim nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive;
18. 'pergjigja e kerkeses kundrejt menaxhimit te kufizimeve te transmetimit' eshte kërkesa brenda nje objekti kërkesë ose sistem te mbyllur shpërndarje qe eshte e disponueshme per modulim nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive per te meanxhuar kufizimet brenda sistemit;
19. 'agregimi i kërkesës 'eshte grupi i objekteve te kërkesës ose sistemeve te mbyllura te shpërndarjes te cilat mund te operojnë si nje objekt i vetëm ose si sistem i mbyllur shpërndarje per qëllimin e ofrimit te nje ose me shume te shërbimeve te përgjigjes se kërkesës ;
20. 'pergjigja e kërkesës kundrejt kontrollit te frekuences' eshte kërkesa brenda nje objekti kerkese ose sistemi te mbyllur shpërndarje qe eshte e disponueshme per te reduktuar ose rritur ne përgjigje te lëkundjeve te frekuencës, te bëra ne menyre te pavarur nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur i shpërndarjes per te shuar keto luhatje;
21. 'pergjigja e kërkesës kundrejt kontrollit shume te shpejte te fuqisë aktive' eshte kërkesa brenda objektit te kërkesës, sistemit te mbyllur te shpërndarjes qe mund te modulohet shume shpejt ne përgjigje te devijimit te frekuencës i cili rezulton ne modifikim shume te shpejte te fuqisë aktive ;
22. 'dokumenti i njësisë me përgjigje te kërkesës'(DRUD0 eshte nje dokument, i lëshuar ose nga pronari i objektit te kërkesës ose nga CDSO per operatorin respektiv te sistemit, per njesite e kërkesës me përgjigje te kërkesës dhe te lidhura ne ose mbi nivelin e tensionit 1000V, dhe qe konfrimon pajtueshmërinë e njësive te kërkesës me kërkesat teknike te përcaktuara ne kete rregullore dhe qe siguron te dhena dhe deklarata te nevojshme , perfshire deklaraten e pajtueshmërisë.

Neni 3

Fusha e Zbatimit

1. Kërkesat e lidhjes të përcaktuara në kete Rregullore do te zbatohen në:
 - a) Objektet e kërkesës te reja qe lidhen ne transmetim;
 - b) Objektet e reja te shpërndarjes qe lidhen ne transmetim;
 - c) Sistemet e reja te shpërndarjes duke perfshire sistemet e reja te mbyllura te shpërndarjes
 - d) Njesite e reja te kërkesës te përdorura nga objekti i kërkesës ose sistem i mbyllur i shpërndarjes per te siguruar shërbimin e përgjigjes se kërkesës per operatoret respektiv dhe OST-te përkatëse .

Operatori respektiv i sistemit do të refuzojë të lejojë lidhjen e një objekti të ri kerkese ne transmetim , objekt shpërndarje te ri qe lidhet ne transmetim, ose një sistem të ri të shpërndarjes, i cili nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe i cili nuk është i mbuluar nga një derogim i dhënë nga autoriteti rregullator, ose autoritet e tjera kur zbatohet në Palët Kontraktuese në përputhje me nenin 50. Operatori i sistemit respektiv do t'ia komunikojnë nje refuzimin e tillë, me anë të një deklarate të arsyetuar me shkrim, pronarit të objektit kërkesës , DSO-se, ose CDSO-se dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe nga autoriteti rregullator, autoritetit rregullator.

Bazuar ne monitorimin e pajtueshmërisë ne përputhje me Titullin III, OST respektive do te refuzoje shërbimin e përgjigjes se kërkesës qe jane subjekte te Nenit 27 deri 30 per njesite e reja te kërkesës qe nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara ne kete Rregullore .

2. Kjo Rregullore nuk do te zbatohet per:
 - a. Objektet e kërkesës dhe sistemet e shpërndarjes qe lidhen ne sistemin e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes, ose ne pjese te sistemit te transmetimit ose sistemeve te shpërndarjes, ne ishujt e Paleve Kontraktuese sistemet e te cilëve nuk operojnë sinkron me BE,GB, Nordik,Irlanden dhe Irlanden e Veriut ose zonën sinkrone Baltike;
 - b. Paisjet magazinuese përveç moduleve gjeneruese pump-storage ne përputhje me Nenin 5(2)
3. Ne rastin e objekteve te kërkesës ose sistemeve te mbyllura te shpërndarjes me më shume se nje njësi kerkese, keto njësi kerkese se bashku do te konsiderohen si nje njësi kerkese nëse nuk mund te operohen ne menyre te pavarur nga njëra tjetra ose ne menyre te aryeshme mund te konsiderohen ne menyre te kombinuar.

Neni 4

Zbatimi ne objektet ekzistuese te kërkesës qe lidhen ne transmetim,objektet ekzistuese te shpërndarjes qe lidhen ne transmetim, sistemet ekzistuese te shpërndarjes dhe njesite ekzistuese te kërkesës qe ofrojnë shërbimin e përgjigjes se kërkesës .

1. Objektet ekzistuese te kërkesës qe lidhen ne transmetim,objektet ekzistuese te shpërndarjes te lidhura ne transmetim, sistemet ekzistuese te shpërndarjes dhe njesite ekzistuese te kërkesës qe jane ose mund te perdoren nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur i shpërndarjes per te siguruar shërbimin e përgjigjes se kërkesës per nje operator respektiv ose OST respektive, nuk jane subjekt i kerkesave te kësaj Rregulloreje përveç ku:

a. Nje objekt ekzistues kërkesë i lidhur ne transmetim, nje objekt ekzistues shpërndarje i lidhur ne transmetim,sistem ekzistues shpërndarje, ose nje njësi ekzistuese kerkese brenda nje objekti kerkese ne ne nivelin e tensionit mbi 1000V ose sistem i mbyllur shpërndarje i i lidhur ne nivelin e tensionit mbi 1000 V, jane modifikuar ne mase te tille qe marrëveshja e saj e lidhjes duhet te rishikohet ne menyre thelbesore ne përputhje me procedurën e meposhtme:

- i. Pronaret e objektit te kërkesës, DSO-te ose CDSO-te te cilat kane ndërmend te ndërmarrin modernizimin e centralit ose zëvendësimin e paisjes qe ndikon ne aftësitë teknike te objektit te kërkesës qe lidhet ne transmetim, objektin e shpërndarjes qe lidhet ne transmetim, sistemin e shpërndarjes ose njësinë e kërkesës do te njoftojnë per planet e tyre paraprakisht operatorit te sistemit;
- ii. Nëse operatori respektiv i sistemit merr parasysh qe shtrirja e modernizimit ose zëvendësimit te paisjes eshte ne mase te tille qe kërkon nje marrëveshje lidhje e re,operatori i sistemit do te njoftoje autoritetin rregullator ose kur aplikohet ,Palën Kontraktuese; dhe
- iii. Autoriteti respektiv rregullator ose, kur zbatohet Pala Kontraktuese do te vendosin nëse nevojitet te rishikohet marrëveshja ekzistuese e lidhjes apo kërkohet marrëveshje e re lidhje dhe cilat kërkesa te kësaj Rregulloreje do te zbatohen;ose

b. Autoriteti rregullator ose, kur zbatohet, Pala Kontraktuese vendos te beje nje objekt ekzistues kërkesë qe lidhet ne transmetim,objekt ekzistues te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim, sistem ekzistues shpërndarës, ose nje njësi ekzistuese kerkese subjekt te te gjithë ose disa prej kerkesave te kësaj Rregulloreje, pas propozimit nga OST respektive ne përputhje me paragrafët 3,4 dhe 5.

2. Për qëllime te ksaj Rregulloreje, nje objekt kerkese qe lidhet ne transmetim,objekt shpërndarje qe lidhet ne transmetim, sistem shpërndarës, ose njësi kerkese qe eshte , ose mund te jete, përdorur nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur i shpërndarjes per te siguruar shërbime te përgjigjes se kërkesës per operatorin respektiv te sistemit ose OST-ne respektive, do te konsiderohen si ekzistuese nëse:

a. Eshte tashme i lidhur ne rrjet ne datën e skadimit të afatit të transpozimit të kësaj Rregulloreje;ose

b. Pronari i objektit te kërkesës, DSO ose CDSO kane përfunduar nje kontrate detyruese finale per blerjen e paisjes kryesore te kërkesës ose njësisë se kërkesës dy vjet pas hyrjes ne fuqi te Rregullores. Pronari i objektit te kërkesës, DSO, ose CDSO-të duhet te njoftojnë operatorin respektiv te sistemit dhe OST-ne respektive per përmbylljen e kontratës brenda 30 muajve pas skadimit të afatit të transpozimit te Rregullores.

Njoftimi i paraqitur nga pronari i objektit te kërkesës ,DSO, ose CDSO per operatorin respektiv te sistemit dhe OST respektive do te tregojë se paku titullin e kontratës, datës e firmosjes se saj dhe datën e hyrjes ne fuqi si dhe specifikimet e paisjes kryesore te kërkesës ose te njësisë se kërkesës qe do te ndërtohet, bashkohet ose blihet.

Nje Palë Kontraktuese mundet te siguroje qe ne rrethana specifike autoriteti rregullator mund te vendosi nëse objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim , objekti i shpërndarjes i lidhur ne transmetim , sistemi i shpërndarjes ose njësia e kërkesës eshte per tu konsideruar si ekzistuese apo e re.

3. Pas konsultimit publik ne përputhje me Nenin 9 dhe me qëllimin e adresimit te ndryshimeve faktike potenciale të rrethanave, të tilla si zhvillimi i kërkesave të sistemit, duke përfshirë futjen e burimeve të rinovueshme të burimeve të energjisë, rrjetet smart, gjenerimin ne shperndarje ose përgjigjen e kërkesës, OST respektive mund ti propozojë autoritetit rregullator në fjalë, ose ku është e aplikueshme, Palës Kontraktuese të shtrijë zbatimin e kësaj Rregulloreje në objektet ekzistuese te kërkesës te lidhura ne transmetim, objektet ekzistuese te shpërndarjes te lidhura ne transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes, ose njërive ekzistuese te kërkesës te përdorura nga një objekt kërkesë ose sistemi te mbyllur të shpërndarjes për të ofruar shërbime të përgjigjes se kërkeses për një operator respektiv te sistemit ose OST respektive.

Per kete qellim do te kryhet nje analize e shendoshe transparente e kosos ne përputhje me Nenin 48 dhe 49. Analiza do te tregojë:

a. Kostot ne lidhje me objektet ekzistuese te kërkesës qe lidhen ne transmetim, objektet ekzistuese te shpërndarjes qe lidhen ne transmetim, sistemet ekzistuese te shpërndarjes dhe njesite ekzistuese te kërkesës , te pajtueshmërisë se kërkuar me kete Rregullore;

b. Përfitimet socio-ekonomike qe rrjedhin nga zbatimi i kerkesave te përcaktuara ne kete Rregullore; dhe

c. Potencialin e masave alternative per të arritur performancen e kërkuar.

4. Para kryerjes së analizës sasiore kosto-përfitim të përmendur në paragrafin 3, OST do të:

a. Beje krahasimin paraprak cilësor te kostove dhe përfitimeve;

b. Perfoje miratime nga autoriteti përkatës rregullator ose, ku aplikohet, Pala Kontraktuese.

5. Autoriteti rregullator respektiv ose, kur është e zbatueshme, Pala Kontraktuese do të vendosin për shtrirjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes, njësitë ekzistuese të kërkesës, brenda gjashtë muajve të marrjes së raportit dhe rekomandimeve të OST respektive në përputhje me paragrafin 4 të nenit 48. Vendimi i autoritetit rregullator ose, kur zbatohet i Palës Kontraktuese do të publikohet.

6. OST respektive duhet të marrë parasysh pritjet legjitime të pronarëve të objektit të kërkesës, të DSO-ve dhe CDSO-ve si pjesë e vlerësimit të zbatimit të kësaj Rregulloreje në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim- ose njesite ekzistuese të kërkesës .

7. OST respektive mund të vlerësojë zbatimin e disa ose të gjitha dispozitave të kësaj Rregulloreje në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes , ose njësi ekzistuese të kërkesës, çdo tre vjet në përputhje me kërkesat dhe procesin e përcaktuar në paragrafët 3 deri 5.

Neni 5

Zbatimi në modulet gjeneruese pump-storage dhe sitet industriale

1. Kjo Rregullore nuk zbatohet për modulet gjeneruese pump-storage që kanë si mënyrën e operimit gjenerim ashtu dhe pompim.

2. Cdo modul pompimi brenda stacionit pump-storage që ka vetëm mënyrën e operimit pompim do të jetë subjekt i kërkesave të kësaj Rregulloreje dhe do të trajtohet si objekt kërkesë.

3. Në rastin e siteve industriale me modul gjeneruese në to, operatori i sistemit të sitit industrial, pronari i objektit të kërkesës, pronari i objektit gjenerues dhe operatori respektiv i sistemit me të cilin sistemi i sitit industrial është lidhur, mund të dakordojnë , në koordinim me OST respektive , për kushtet për çkycje të ngarkesave kritike nga sistemi respektiv. Objektivi i marrëveshjes do të jetë të sigurohet proces i sigurtë i prodhimit të sitit industrial në rast të kushteve me shqetësime në sistemin respektiv.

Neni 6

Aspektet rregullatore

1. Kërkesat e aplikimit të përgjithshëm për tu përcaktuar nga operatori respektiv i sistemit ose OST-te nën këto Rregullore do të jenë subjekt i aprovimit nga autoriteti i dizenuar nga Pala Kontraktuese dhe do të behen publike. Subjekti i dizenuar do të jetë autoriteti rregullator përveç nëse parashikohet ndryshe nga Pala Kontraktuese.

2. Kërkesat specifike për sistemet që përcaktohen nga operatorët respektiv të sistemit ose OST-te sipas kësaj Rregulloreje, Palët Kontraktuese mund të kërkojnë miratim nga Enti i dizenuar për këto .
3. Kur zbatohen këto Rregullore, Palët Kontraktuese, subjektet kompetente dhe operatorët e sistemit duhet të :
 - a. zbatojnë parimin e proporcionalitetit dhe mos-diskriminimit;
 - b. sigurojnë transparencë;
 - c. zbatojnë parimin e optimizimit ndërmjet efikasitetit të përgjithshëm me të lartë dhe kostot totale me të ulët për të gjitha palët e përfshira;
 - d. respektojnë përgjegjësinë e caktuar për OST respektive me qëllim ruajtjen e Sigurisë Operative të Sistemit , duke e përfshirë sic kërkohet në legjislacionin kombëtar;
 - e. konsultohen me DSO-te dhe marrin parasysh ndikimet potenciale në sistemin e tyre;
 - f. marrin parasysh standartet evropiane të dakorduara dhe specifikimet teknike;
4. Operatori i Sistemit respektiv ose OST duhet të paraqesin një propozim për kërkesat e zbatimit të përgjithshëm, ose metodologjinë e përdorur për të llogaritur ose përcaktuar ato, për miratim nga organi kompetent brenda dy vjetëve nga skadimit të afatit të transpozimit të kësaj rregulloreje.
5. Ku kjo rregullore kërkon që operatori i sistemit respektiv, OST respektive, pronari i objektit të kërkesës, pronari i objektit gjenerues, OSSH dhe / ose CDSO të kërkojnë marrëveshje, ata do të përpiqen ta bëjnë këtë brenda gjashtë muajve pas një propozimi të parë të paraqitur nga njëra palë për palën tjetër. Nëse nuk është gjetur një marrëveshje brenda këtij harku kohor, secila palë mund të kërkojë nga autoriteti përkatës rregullator të nxjerrë një vendim brenda gjashtë muajsh.
6. Subjektet kompetente duhet të marrin vendime mbi propozimet për kërkesat apo metodologjitë brenda gjashtë muajve pas marrjes së propozimeve të tilla.
7. Nëse operatori respektiv i sistemit ose OST-ja e konsideron të nevojshëm amendimin e kërkesave apo metodologjisë së parashikuar dhe të miratuar sipas paragrafit 1 dhe 2, për amendimin e propozuar zbatohen kërkesat e parashikuara në paragrafët 3 deri 8. Operatorët e sistemit dhe TSO-te që propozojnë një amendim, do të marrin parasysh pritjet legjitime, nëse ka, të pronarëve të objektit të kërkesës, DSO-ve, CDSOs, prodhuesve të pajisjeve dhe aktorëve të tjerë në bazë të kërkesave ose metodologjive të përcaktuara apo të rena dakord në fillim.
8. Çdo palë që ka ankesë kundër një operatori sistemi respektiv ose OST-je në lidhje me detyrimet që operatori i sistemit respektiv ose OST-së sipas kësaj rregulloreje, mund të ankimojë në autoritetin rregullator i cili, duke vepruar si autoritet për zgjidhjen e

mosmarrëveshjeve, merr vendim brenda dy muajve pas marrjes së ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet për dy muaj, ku kërkohet informacion shtesë nga autoriteti rregullator. Kjo periudhë e zgjatur mund të vazhdohet më tej me miratimin e ankuesit. Vendimi i autoriteti rregullator i do të ketë efekt detyrues, përveç dhe deri sa të rrezohet pas apelimit.

9. Ku kërkesat sipas kësaj Rregulloreje duhen vendosur nga operatori i sistemit respektiv që nuk është një TSO, Palët Kontraktuese mund të parashikojnë që në vend të kësaj OST-je të jenë përgjegjëse për vendosjen e kërkesave përkatëse.

Neni 7

OST-te Shumefishe

1. Nëse në një Palë Kontraktuese ka më shumë se një OST, kjo rregullore do të zbatohet në të gjitha OST-te.

2. Palët Kontraktuese mundën nën regjimin e rregullatorit kombëtar, të sigurojnë që përgjegjësia e një OST-je për të përmbushur një ose disa ose të gjitha detyrimet nën këtë Rregullore është nënshkruar nga një ose më shumë OST specifike.

Neni 8

Mbulimi i kostove

1. Shpenzimet që mbarten nga operatorët e sistemit që janë subjekt i tarifës së rregulluar të rrjetit dhe që rrjedhin nga detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore do të vlerësohen nga autoritetet përkatëse rregullatore. Kostot e vlerësuara si të arsyeshme, efikase dhe proporcionale do të mbulohen përmes tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm.

2. Nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore përkatëse, operatorët e sistemit të përmendur në paragrafin 1, brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, të sigurojnë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar vlerësimin e shpenzimeve të bëra.

Neni 9

Konsultimi publik

1. Operatorët e sistemit respektiv dhe OST-te respektive do të kryejnë një konsultim me palët e interesit, përfshirë autoritetet kompetente të secilit Palë Kontraktuese mbi :

a. Propozimet për shtrirjen e zbatueshmërisë së kësaj Rregulloreje në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhura në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njesitë ekzistuese të kërkesës në përputhje me Nenin 4(3);

- b. Raportin e përgatitur në përputhje me Nenin 48(3);
 - c. Analizën e kostos të ndermarre në përputhje me Nenin 53(2);
 - d. Kërkesat për njësitë e kërkesës të specifikuar në përputhje me Nenin 28 (2) (c), (e), (f), (k) dhe (l) dhe Neni 29 (2) (c) deri (e). Konsultimi do të zgjasë për se paku një muaj.
2. Operatorët përkatës të sistemit ose TSO-të respektive duhet të marrin siç duhet parasysh pikëpamjet e palëve të interesuara që rezultojnë nga konsultimet, para paraqitjes së projekt-propozimit, raportit, analizës kosto-përfitim, apo kërkesave për njësitë e kërkesës, për miratim nga autoriteti rregullator, organi kompetent ose, nëse është e aplikueshme, Palë Kontraktuese. Në të gjitha rastet, do të jepet një justifikim i shëndoshë për përfshirjen ose jo të pikëpamjeve të palëve të interesuara, dhe publikohet në kohën e duhur para, ose njëkohësisht me të, të publikimit të propozimit, raportit, analizës kosto- përfitim, apo kërkesat për njësitë e kërkesës të përcaktuara në përputhje me nenin 28 dhe nenin 29.

Neni 10

Përfshirja e grupeve të interesit

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim të ngushtë me ENTSO për Energjinë, organizon përfshirjen e grupeve të interesit në lidhje me kërkesat për lidhjen me rrjetin të objekteve të kërkesës që lidhen në transmetim, objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njësive të kërkesës të përdorur nga një objekt kërkesë ose nga një rrjet i mbyllur shpërndarje për të ofruar shërbime të përgjigjes së kërkesës për operatorët respektiv të sistemit dhe OST-ve respektive, si dhe aspekte të tjera të zbatimit të kësaj Rregulloreje. Kjo do të përfshijë takime të rregullta me palët e interesuara për të identifikuar problemet dhe të për të propozuar përmirësime që lidhen kryesisht me kërkesat për lidhjen me rrjetin e transmetimit të objekteve të kërkesës, objektet shpërndarjes që lidhen në transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njësive të kërkesës përdorura nga një objekt i kërkesës ose një sistem të mbyllur të shpërndarjes për të ofruar shërbime të përgjigjes së kërkesës për operatorët respektiv të sistemit dhe OST-te respektive.

Neni 11

Detyrimet e konfidencialitetit

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, shkëmbyer ose i transmetuar në bazë të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i kushteve të sekretit profesional e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4.
2. Detyrimi i sekretit profesional do të zbatohet për çdo person, autoritetet rregullatore, ose subjektet që i nënshtrohen dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. informacioni konfidencial i përftuar nga personat, autoritetet rregullatore, ose subjektet përmendura në paragrafin 2 në rrjedhën e detyrave të tyre nuk mund të ipen për çdo person ose autoritet tjetër, prejashtuar rastet e mbuluara nga ligji kombëtar, dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje ose ligje të tjera përkatëse të Unionit.

4. Prejashtuar rastet e mbuluara nga ligji kombëtar ose i Unionit, autoritetet rregullatore, subjektet apo personat që marrin informacion konfidencial në pajtim me këtë Rregullore mund ta përdorin atë vetëm për qëllim të kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj Rregulloreje.

TITULLI II

LIDHJA E OBJEKTEVE TE SHPËRNDARJES QE LIDHEN NË TRANSMETIM DHE SISTEMET E SHPERNDARJES

Kapitulli 1

KERKESA TE PERGJITHSHME

Neni 12

Kërkesa të përgjithshme për frekuencën

1. Objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes do të jenë të afta të mbeten të lidhura me rrjetin dhe operojnë në diapazone të frekuencës dhe periudhat e kohës të specifikuar në Aneksin 1.

2. Pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose DSO mund të dakordojnë me OST-ne respektive për diapazone me të gjere të frekuencës ose kohe minimale operimi me të gjata. Nëse diapazone me të gjere frekuence ose kohe minimale operimi me të gjata janë të përshtatshme, pëlqimi i pronarit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim OSSH-së nuk do të refuzohet pa shkak.

Neni 13

Kërkesat e përgjithshme për tensionin

1. Objektet e kërkesës që lidhen në transmetim, objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim duhet të jenë në gjendje të mbeten të lidhura me rrjetin dhe operojnë në diapazonet e tensionit dhe kohën e specifikuar në Aneksin 2

2. Paisjet e sistemeve te shpërndarjes qe lidhen ne te njëjtin tension si tensioni ne piken e lidhjes me sistemin e transmetimit do te jene ne gjendje te mbeten te lidhura me rrjetin dhe operojne ne diapazonet dhe periudhat e kohës te specifikuara ne Aneksin II.

3. Diapazoni i tensionit në pikën e lidhjes do të shprehet me tensionin në pikën e lidhjes në lidhje me tensionin referencë 1(pu) për njësi tensioni. Për nivelin 400 kV të tensionit te rrjetit (ose si alternativë zakonisht të referuar si niveli 380 kV), vlera 1 pu është 400 kV, për nivelet e tjera të tensionit të rrjetit referenca 1 pu e tensionit mund të ndryshojnë për çdo operator te sistemit në të njëjtën zonë sinkrone.

4. Kur tensioni baze per vlerat e pu eshte nga 300kV deri 400kV(perfshire vlerën 400), OST respektive ne Spanje mund te kerkoje nga objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim,objektet e shpërndarjes te lidhura ne transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim te mbeten te lidhura ne diapazonin e tensionit ndërmjet 1.05pu -1.0875 pu per nje kohe te pacaktuar.

5. Ku tensioni baze për vlerat pu është 400kV, OST-te respektive në zonen sinkrone te Balltikut mund të kërkojnë nga objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim , objektet e shpërndarjes të lidhur te lidhura ne transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim të mbeten te lidhur me rrjetin 400 kV per diapazonet e tensionit dhe periudha kohe qe zbatohen ne zonën sinkrone te Evropës Kontinentale.

6. Nese kërkohet nga OST respektive, nje objekt kerkese i lidhur ne transmetim, nje objekt shpërndarje i lidhur ne transmetim, ose nje sistem shpërndarje i lidhur ne transmetim duhet te jete ne gjendje per ckycje automatike ne tension specifik.Termet dhe parametrat per ckycje automatike do te dakordohen ndërmjet OST-se respektive dhe pronarit te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose me OSHE-.

7. Ne lidhje me sistemet e shpërndarjes , të lidhur në transmetim me tension ne piken e lidhjes poshtë 110 kV , OST respektive do te specifikojë diapazonin e tensionit ne piken e lidhjes qe sistemet e shpërndarjes te lidhur ne transmetim do te dizenjohen ti bere balle. DSO-te do te dizenjojne aftësitë e paisjeve te tyre , te lidhura ne te njëjtin tension si tensioni ne piken e lidhjes me sistemin e transmetimit, ne përputhje me diapazonin e tensionit.

Neni 14

Kerkesat per lidhjen e shkurter

1. Bazuar ne shkallen e aftësisë se përballimit te lidhjes shkurtër te elementeve te rrjetit te saj te transmetimit, OST respektive duhet te specifikojë rrymën maksimale te lidhjes se shkurtër ne piken e lidhjes ku objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim ose sistemi i shpërndarjes i lidhur ne transmetim do te jete ne gjendje te perballoje.

2. OST respektive duhet te paraqese per pronarin e objektit kerkese te lidhur ne transmetim ose operatorin e sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim nje vlerësim te rrymës se shkurtes maksimale dhe minimale qe pritet ne piken e lidhjes si nje ekujvalente te rrjetit.

3. Pas nje ngjarje te paplanifikuar , OST respektive do te informoje pronarin e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatoret e sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim qe jane prekur,sa me shpejt te jete e mundur dhe jo me vone se nje jave pas ngjarjes se paplanifikuar , per ndryshimet mbi prapun e rrymes se lidhjes se shkurtër maksimale qe prek objektin e kërkesës te lidhur ne transmetim ose sistemin e shpërndarjes te lidhur ne transmetim qe preket dhe qe duhet te jete ne gjendje te perballoje nga rrjeti i OST-se respektive ne përputhje me paragrafin 1.

4. Pragu i përcaktuar ne paragrafin 3 duhet ose te specifikohet nga pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim per objektin e tij, ose nga operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim per rrjetin e tij.

5. Para nje ngjarje te planifikuar , operatori respektiv duhet te informoje pronarin e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori e sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim , sa me shpejt te jete e mundur por jo me vone se nje jave para ngjarjes se planifikuar, per ndryshimet mbi prapun per rryme maksimale te lidhjes se shkurtër qe objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim i prekur ose sistemi i shpërndarjes i lidhur ne transmetim i prekur duhet te jene ne gjendje te përballojnë nga rrjeti i OST-se respektive, ne përputhje me paragrafin 1.

6. Pragu i përcaktuar ne paragrafin 5 ose duhet te specifikohet nga pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim per objektin e tij ose nga operatori i shpërndarjes se lidhur ne transmetim per rrjetin e tij.

7. OST respektive duhet te kerkoje informacion nga nje pronar objekti te kërkesës te lidhur ne transmetim ose nje operator i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim informacion ne lidhje me kontributin ne terma te rrymës se lidhjes se shkurtër nga objekti ose rrjeti.Minimalisht modulet ekujvalente te rrjetit duhet te paraqiten dhe demonstrohen per sekuence 0, negative dhe poizitive.

8. Pas nje ngjarje te paplanifikuar , pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operator i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim duhet te informoje OST-ne respektive , sa me shpejt te jete e mundur dhe jo me vone se nje jave pas ngjarjes se paplanifikuar, per ndryshimet ne kontributin e lidhjes se shkurtër mbi prapun e vendosur nga OST respektive.

9. Para nje ngjarje te planifikuar, pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim do te informojnë OST-ne respektive , sa me shpejt te jete e mundur dhe jo me vone se nje jave pas ngjarjes se planifikuar, per ndryshimet ne kontributin e lidhjes se shkurtër mbi prapun e përcaktuar nga OST respektive.

Neni 15

Kerkesat per fuqi reaktive

1. Objektet e kërkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim duhet të jenë në gjendje të mbajnë operimin në gjendje të qëndrueshme në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a. Për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, diapazoni aktual i fuqisë reaktive të specifikuar nga OST respektive për importim dhe eksportim të fuqisë reaktive nuk do të jetë më i gjërë se 48% i kapacitetit maksimal të importit ose i kapacitetit maksimal të eksportit (0.9 e faktor fuqie për import ose eksport të fuqisë reaktive, përveç situatave kur demonstrohen përfitime si teknike dhe financiare të sistemit, për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim nga pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim dhe e pranuar nga OST respektive;

b. Për sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim, diapazoni aktual i fuqisë reaktive të specifikuar nga OST respektive për importim dhe eksportim të fuqisë reaktive nuk do të jetë më i gjërë se:

- i. 48% (0.9 faktor fuqie) të kapacitetit maksimal të importit me të madh ose kapacitetit maksimal të eksportit gjatë importit të fuqisë reaktive (konsum); dhe
- ii. 48 % (dmth 0.9 faktor fuqie) të kapacitetit maksimal të importit me të madh ose kapacitetit të eksportit maksimal gjatë eksportit të energjisë reaktive (prodhimit);

përveç situatave kur arrihen përfitime teknike dhe financiare nga OST dhe operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim nëpërmjet analizës së përbashkët.

c. OST respektive dhe operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim duhet të dakordojnë mbi fushën e analizës, e cila duhet të adresojë zgjidhje të mundshme, dhe përcaktojë zgjidhje optimale për shkëmbime të fuqive reaktive të sistemeve të tyre, duke marrë në mënyrë adekuate në konsideratë karakteristikat specifike të sistemit, struktura e ndryshueshme e shkëmbimit të energjisë, flukset dydrejtimshme dhe aftësitë për fuqi reaktive në sistemin e shpërndarjes;

d. OST respektive mund të përcaktojë përdorimin e parametrave të ndryshëm nga faktori i fuqisë me qëllim që të vendosin diapazonin ekuivalent të aftësisë për fuqi reaktive;

e. Vlerat e diapazonit të kërkesës për fuqi reaktive do të plotësohen në pikën e lidhjes;

f. Me anë të anashkalimit nga pika (e), kur një pikë lidhje ndahet ndërmjet një moduli gjenerues dhe një objekti kërkesë, kërkesat ekuivalente duhet të përmbushen në pikën e përcaktuar në marrëveshjet respektive të ligjit nacional.

2. OST respektive mund të kërkojë që sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim të kenë aftësi në pikën e lidhjes për të mos eksportuar fuqi reaktive (në tension reference 1 pu) në një fluks të fuqisë aktive prej më pak se 25% të kapacitetit maksimal të importit. Ku është e zbatueshme, Palet Kontraktuese mund të kërkojnë nga OST respektive të justifikojë kërkesën e vet me anë të një analize të përbashkët me operatorin e sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim. Nëse kjo kërkesë nuk është e justifikuar në bazë të analizës së përbashkët, OST respektive dhe operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord për kërkesat e nevojshme në bazë të rezultateve të analizës së përbashkët.

3. Pa rënë ndesh me pikën (b) të paragrafit 1, OST respektive mund të kërkojë sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim të kontrollojë në mënyrë aktive shkëmbimin e fuqisë reaktive në pikën e lidhjes për përfitime të të gjithë sistemit. OST respektive dhe operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord për metodën për të kryer këtë kontroll, për të siguruar nivelin e justifikuar e sigurisë së furnizimit për të dy palët. Arsyetimi duhet të përfshijë një plan në të cilin specifikohen hapat dhe afati kohor për përmbushjen e kërkesës .

4. Në përputhje me paragrafin 3, operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim mund të kërkojë OST respektive të marrë në konsideratë sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim për menaxhim të fuqisë reaktive.

Neni 16

Kerkesat per mbrojtjen

1. OST respektive duhet të specifikojë paisjet dhe parametrat e kërkuar për të mbrojtur rrjetin e transmetimit ose sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim. OST respektive dhe pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord mbi skemat e mbrojtjes dhe tarimet përkatëse për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim.

2. Mbrojtja elektrike e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose të sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim duhet të ketë përparësi mbi kontrollin operacional ndërkohë që respektohet siguria operative , shëndeti dhe siguria e personelit dhe e publikut.

3. Paisjet e skemave të mbrojtjes mund të mbulojnë elementet e mëposhtëm:

- a. lidhjen e shkurtër të jashtme dhe të brendshme;
- b. mbi/nen-tensioni në pikën e lidhjes me sistemin e transmetimit;
- c. mbi/nen-frekuenca;
- d. mbrojtja e qarkut të kërkesës

- e. mbrojtja e njësisë së transformatorit;
 - f. skemat rezerve kunder keqfunksionimit të mbrojtjes dhe refuzimit të celesave
4. OST respektive dhe pronari i objektit të kërkesës e lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes i lidhur në transmetim do të dakordojnë mbi çdo ndryshim në skemat përkatëse të mbrojtjes për objektin e kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim, dhe çdo ndryshim në marrëveshjet për skemat e mbrojtjes së objekteve të kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim.

Neni 17

Kerkesat për kontrollin

1. OST respektive dhe pronari i objektit të kërkesës së lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes i lidhur në transmetim do të dakordojnë mbi skemat dhe parametrat e paisjeve të ndryshme të kontrollit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemit respektiv të shpërndarjes të lidhur në transmetim për sigurinë e sistemit .
2. Marrëveshja do të mbulojë së paku elementet e mëposhtëm:
- a. operimin e izoluar të rrjetit;
 - b. shuarjen e lëkundjeve;
 - c. shqetësimet në sistemin e transmetimit;
 - d. çkyçje automatike në furnizim emergjence dhe rivendosje në topologjinë normale;
 - e. rikyçjen automatike të celesit (në difektet 1 fazore)
3. OST respektive dhe pronari i objektit të kërkesës i lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes i lidhur në transmetim do të bien dakord për çdo ndryshim në skemat dhe tarimet e paisjeve të ndryshme të kontrollit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose të sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim për sigurinë operative.
4. Në lidhje me renditjen e prioritetit të mbrojtjes dhe kontrollit, pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes i lidhur në transmetim do të përcaktojnë paisjet e mbrojtjes dhe kontrollit të objekteve të kërkesës të lidhura në transmetim ose të sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim respektivisht , në përputhje me renditjen e prioritetit , të organizuar në rend zbritës sipas rëndësisë :
- a. mbrojtja e rrjetit të transmetimit;

- b. mbrojtja e objektit të kërkesës ose sistemit të shpërndarjes të lidhura në transmetim;
- c. kontroll i frekuencës (rregullim i fuqisë aktive);
- d. kufizimet e fuqisë

Neni 18

Shkembimi i Informacionit

1. Objektet e kërkesës të lidhura në transmetim do të pësojnë në përputhje me standartet e specifikuar nga OST respektive me qëllim që të shkëmbejnë informacion ndërmjet OST respektive dhe objektit të kërkesës të lidhur në transmetim në afatet e kohës të specifikuar. OST respektive do të bëjnë të disponueshme publikisht standartet.
2. Sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim do të pësojnë në përputhje me standartet e specifikuar nga OST respektive me qëllim që të shkëmbejnë informacion ndërmjet OST-se respektive dhe sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim në afatet kohore të specifikuar. OST respektive do të bëjnë të disponueshme publikisht standartet.
3. OST do të specifikojë standartet e shkëmbimit të informacionit. OST respektive duhet të bëjnë publike listën e saj të të dhenave të kërkuara.

Neni 19

Çkycja e kërkesës dhe rilidhja e kërkesës

1. Te gjitha objektet e kërkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim do të përmbushin kërkesat e mëposhtme në lidhje me aftësinë funksionale për çkycjen e kërkesës në frekuencë të ulët.
 - a. Cdo operator i sistemit të shpërndarjes i lidhur në transmetim dhe, kur specifikohet nga OST, pronar objekti kërkesë të lidhur në transmetim, do të sigurojë aftësitë që të bëjnë të disponueshme çkycjen automatike nga "nenfrekuenca" në një raport të caktuar të kërkesës së tyre. OST respektive mund të specifikojë çkycjen në baze të nxitjes së kombinimit të nenfrekuenca dhe shkallës-se-ndryshimit-me-hap-te-frekuencës;
 - b. Aftësitë funksionale për çkycje të kërkesës nga nenfrekuenca do të lejojnë çkycje të kërkesës në shkallët e diapazonit të frekuencave operacionale.

c. Aftësitë funksionale për çkyçje të kërkesës nga nenfrekuenca do të lejojnë për tu operuar hyrja e Rrymes Alternative ("AC") nominale që do të specifikohet nga operatori respektiv i sistemit dhe do të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- i. Diapazoni i frekuencës :se paku ndërmjet 47-50 Hz, i rregullueshem me hapa 0.05 Hz;
- ii. Koha e operimit; jo më shumë se 150 ms pas ngacimit të tarimit të frekuencës dhe jo më shumë se 450 ms pas nxitjes së pikës së caktuar të frekuencës në Gjeorgji;
- iii. Bllokimi i tensionit: bllokimi i aftësive funksionale do të jete i mundur kur tensioni është brenda rangut 30-90% të Tensionit referent 1 pu;
- iv. Sigurojë drejtimin e flukseve të fuqisë aktive në pikën e çkyçjes;

d. Paisja e tensionit AC e përdorur për sigurimin e aftësive funksionale për çkyçje automatike, do të sigurohet nga rrjeti në pikat e matjes së sinjalit të frekuencës, sic përdoret në sigurimin e aftësive funksionale në përputhje me paragrafët 1(c), pra tensioni i paisjes së aftësive funksionale të çkyçjes së kërkesës nga nenfrekuenca është e njëjta me të rrjetit.

2. Në lidhje me aftësitë funksionale të çkyçjes kërkesës nga nentensioni, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a. OST respektive mund të specifikojë në koordinim me operatorët e sistemit të lidhur në transmetim, aftësitë funksionale për çkyçje automatike të kërkesës nga nentensioni për objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim;

b. OST respektive mund të specifikojë në koordinim me pronarët e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, aftësitë funksionale për çkyçje automatike të kërkesës nga nentensioni për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim;

c. Bazuar në vlerësimin e OST-se në lidhje me sigurinë e sistemit, zbatimi i bllokimit të rregullatorit të degëzimeve në ngarkesë dhe çkyçja e kërkesës nga nentensioni do të jete të detyruara për operatorët e sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim;

d. Nëse OST përkatëse vendos të zbatojë aftësinë funksionale të çkyçjes kërkesës nga nentensioni, paisja për bllokimin e degëzimeve të rregullatorit në ngarkesë dhe paisja për çkyçjen automatike të kërkesës do të instalohen në koordinim me OST respektive;

e. Metoda për çkyçjen e kërkesës nga nentensioni do të aplikohet ose nga dhoma e kontrollit ose relete;

f. Aftësitë funksionale të çkyçjes së kërkesës nga nentensioni do të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- i. Aftësia funksionale për çkyçje të kërkesës nga nentensioni do të monitorojë matjet e tensionit në të tre fazat;
 - ii. Bllokimi i operimit të releve do të bazohet në drejtim të flukseve të fuqisë aktive ose reaktive
3. Në lidhje me bllokimin degëzimeve të rregullatorit në ngarkese, do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:
- a. Nëse kërkohet nga OST respektive, transformatori në objektin e shpërndarjes të lidhur në transmetim do të jetë në gjendje për çkyçje automatike ose manuale të bllokuesit në ngarkese të degëzimeve.
 - b. OST respektive do të specifikojë aftësinë funksionale të bllokuesit të degëzimeve në ngarkese të rregullatorit.
4. Të gjitha objektet e kërkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim do të përmbushin kërkesat e mëposhtme në lidhje me çkyçjen ose rilidhjen automatike të objekteve të kërkesës të lidhura në transmetim ose sistemeve të shpërndarjes të lidhura në transmetim:
- a. Në lidhje me aftësinë për rilidhje pas çkyçjes, OST respektive duhet të specifikojë kushtet nën të cilat objekti i kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemi i shpërndarjes të lidhur në transmetim është i caktuar të rilidhet me sistemin e transmetimit. Instalimet e sistemeve për rilidhje automatike duhet të jenë subjekt i paraautorizimit nga OST respektive;
 - b. Në lidhje me rilidhjen e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose sistem të shpërndarjes të lidhur në transmetim, objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose sistem të shpërndarjes të lidhur në transmetim duhet të jetë i aftë për sinkronizim të frekuencave brenda diapazonit të vendosur në Nenin 12. OST respektive dhe pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord për tarimet e paisjeve sinkronizuese para lidhjes së objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, duke përfshirë tensionin, frekuencën, diapazonin e këndit të fazës dhe devijimin e tensionit ose frekuencës;
 - c. Një objekt kërkesë i lidhur në transmetim ose një objekt i shpërndarjes i lidhur në transmetim do të jetë në gjendje të çkyçet në distance nga sistemi i transmetimit kur kërkohet nga OST. Nëse kërkohet, paisje të çkyçjes automatike për rikonfigurim të sistemit në përgatitje për ngarkesën bllok do të specifikohet nga OST respektive. OST respektive do të specifikojë kohën e kërkuar për çkyçje në distance.

Neni 20

Cilesia e energjisë

Pronaret e objekteve te kerkeses te lidhura ne transmetim dhe operatoret e sistemit te shperndarjes te lidhur ne transmetim do te sigurohen qe lidhjet e tyre me rrjetin nuk do te ndikojne ne nivelin e crregullimeve ose lekundjeve te tensionit te furnizimit ne piken e lidhjes. Niveli i crregullimit nuk do te kaloje ate te lejuarin per ata, nga OST respektive. OST-te duhet te koordinojne kerkesat e tyre per cilësinë e energjisë me kerkesat per OST-te fqinje.

Neni 21

Modelet e simulimit

1. Objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim dhe sistemet e shpërndarjes te lidhura ne transmetim do te përmbushin kërkesat e përcaktuara ne paragrafët 3 dhe 4 ne lidhje me modelet e simulimit ose informacionin ekuivalent.
2. Cdo OST mund te kerkoje modele simulimi ose informacion ekuivalent duke treguar sjelljen e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, ose sistemin e shpërndarjes te lidhur ne transmetim, ne te dyja gjendjet dinamike dhe statike.
3. Cdo OST do te specifikojë përmbajtjen dhe formatin e ketyre modeleve te simulimit ose informacioni ekuivalent. Përmbajtja dhe formati do te përfshijnë:
 - a. gjendjen statike dhe dinamike , perfshire komponenten 50 Hz;
 - b. simulimet kalimtare elektromagnetike ne piken e lidhjes;
 - c. strukturën dhe bllok-diagramat.
4. Per qëllime te simulimeve dinamike, modelet e simulimit ose informacionet ekuivalente te përmendura ne paragrafët 3(a) do te përmbajnë nen-modelet ose informacionin ekuivalent te mëposhtëm:
 - a. Kontrolli i fuqisë;
 - b. Kontrolli i tensionit
 - c. Objekti e kërkesës i lidhur ne transmetim dhe modelet e mbrojtjes se sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim;
 - d. Tipet e ndryshme te kërkesës dmth karakteristikat elektroteknike te kërkesës; dhe
 - e. Modelet e konvertimit

5. Cdo operator sistemi ose OST respektive duhet te specifikojnë kërkesat e performancës se regjistrimit te objekteve te kërkesës te lidhura ne transmetim ose te objekteve te shpërndarjes te lidhura ne transmetim, ose te dyja me qellim qe te krahasohet përgjigja e modelit me keto regjistrime .

Kapitulli 2

PROCEDURA E NJOFTIMIT OPERATIV

Neni 22

Dispozita te pergjithshme

1. Procedura e njoftimit operacional per lidhjen e cdo objekti kerkese qe lidhet ne transmetim, cdo objekti te ri te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim dhe cdo sistem te ri shpërndarje qe lidhet ne transmetim, do te perbehet nga:
 - a. njoftimi i energjizimit operacional(EON);
 - b. njoftimi operacionale i përkohshëm(ION);
 - c. njoftimi operacionale final(FON)
2. Cdo pronar i objektit kërkesës te lidhur ne transmetim ose operator i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim mbi te cilin zbatohen nje ose me shume kërkesa te Titullit II duhet ti demostroje OST-se respektive qe ka përmbushur kërkesat e caktuara ne Titullin II te Rregullores nga kompletimi me sukses i procedurës se njoftimit operacional per lidhjen e cdo objekti kerkese te lidhur ne transmetim, objekti te shpërndarjes te lidhur ne transmetim dhe cdo sistemi shpërndarje te lidhur ne transmetim , te përshkruar ne Nenin 23 deri 26.
3. OST respektive do te specifikojte dhe beje publike detajet e mëtejshme ne lidhje me procedurën e njoftimit operacional.

Neni 23

Njoftimi i energjizimit operacional

1. Nje EON do ti japë te drejte pronarit te objektit te kërkesës qe lidhet ne transmetim ose operatorit te sistemit te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim te energjizojte rrjetin e tij

te brendshem dhe paisjet ndihmese duke përdorur lidhjet me rrjetin qe eshte specifikuar per piken e lidhjes.

2. Nje EON do te lëshohet nga OST respektive, ne baze te plotësimit te përgatitjeve perfshire marrëveshjen mbi tarimet e mbrojtjes dhe kontrollit te rëndësishme per piken e lidhjes ndërmjet OST respektive dhe pronarit te objektit te kërkesës qe lidhet ne transmetim ose operatorit te sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim.

Neni 24

Njoftimi operacional i përkohshëm

1. Nje EON i jep te drejte pronarit te objektit te kërkesës qe lidhet ne transmetim ose operatorit te sistemit te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim te operoje objektin e kërkesës qe lidhet ne transmetim, objektin e shpërndarjes qe lidhet ne transmetim ose sistemin e shpërndarjes te lidhur ne transmetim duke përdorur lidhjet me rrjetin per nje kohe te kufizuar.

2. Nje ION do te lëshohet nga nje OST, ne baze te procesit te plotësimit shqyrtimit te te dhenave dhe sic kërkohet nga ky Nen.

3. Ne lidhje me shqyrtimin e te dhenave dhe studimit , OST respektive do te kete te drejte te kerkoje qe pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim te paraqesë:

a. Deklaratë te detajuar te pajtueshmërisë;

b. Te dhena teknike te detajuara te objektit te kërkesës qe lidhet ne transmetim, objektit te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim ose sistemit respektiv te shpërndarjes qe lidhet ne transmetim per lidhjen me rrjetin sic specifikohet nga OST respektive;

c. Certifikata te paisjeve te lëshuara nga certifikues i autorizuar ne respekt te objekteve te kërkesës te lidhura ne transmetim, objekteve te shpërndarjes te lidhura ne transmetim dhe sistemet e shpërndarjes te lidhura ne transmetim kur mbi keto jane mbështetur pjese te provave te pajtueshmërisë;

d. Modelet e simulimit, sic specifikohet ne Nenin 21 dhe kërkohet nga OST;

e. Studime qe demonstrojnë performancen e pritur ne gjendje dinamike dhe statike sic kërkohet ne Nenin 43,46 dhe 47;

f. Detajet te metodës praktike te ndjekur per plotësimin e testeve te pajtueshmërisë ne përputhje me Kapitullin 2 te Titullit IV.

4. Koha maksimale gjate te cilës pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatorit te sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim mund të mbajë statusin

ION do të jetë 24 muaj. OST respektive ka të drejtë të përcaktojë një periudhë me të shkurtër ION të vlefshmërisë. Një zgjatje e ION do të jepet vetëm nëse pronari i objektit kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim ka bërë përparim të konsiderueshëm drejt pajtueshmërisë së plotë. Çështjet e pazgjidhura duhet të identifikohen qartë në kohën e kërimit të zgjatjes së kohës ION.

5. Zgjatja e periudhës gjatë së cilës pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim mund të mbajë statusin e ION, përtej periudhës së përcaktuar në paragrafin 4, mund të jepet në qoftë se kërkesa për përjashtim është bërë për OST përkatëse para skadimit të kësaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përcaktuar në nenin 50.

Neni 25

Njoftimi operacional final

1. Nje FON i jep të drejtë pronarit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatorit të sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim të operojë objektin e kërkesës të lidhur në transmetim, objektin e shpërndarjes të lidhur në transmetim ose sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim duke përdorur lidhjen me rrjetin.

2. Nje FON do të leshohet nga OST respektive, pas heqjes paraprakisht të të gjitha papajtueshmërive të identifikuar për qëllime të statusit ION dhe në bazë të plotësimit me të dhëna të procesit të rishikimit të studimit sic kërkohet nga ky Nen.

3. Për qëllime të të dhënave dhe rishikimit të studimit, pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim duhet të paraqesin për OST respektive si më poshtë:

a. deklaratë të detajuar të pajtueshmërisë; dhe

b. përditesim të të dhënave teknike të zbatueshme, modeleve të simulimit dhe studimeve sic referohet në pikat (b), (d) dhe (e) të Nenin 24(3), përfshirë përdorimin e vlerave të matjeve aktuale gjatë testimit.

4. Nëse është identifikuar papajtueshmëri në lidhje me lëshimin e FON, mund të jepet një derogim me anë të kërkesës të bërë për OST respektive, në përputhje me procedurën e derogimeve të përshkruar në Kapitullin 2 të Titullit V. Nje FON do të leshohet nga OST përkatëse nëse objekti i kërkesës të lidhur i transmetim, objekti i shpërndarjes së lidhur në transmetim, ose sistemi i shpërndarjes i lidhur në transmetim përmbush dispozitat e derogimit.

Kur një kërkesë për derogim refuzohet, OST respektive do të ketë të drejtën të refuzojë lejimin e operimit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, ose sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim deri sa pronari i objektit

te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim dhe OST respektive te zgjidhin papajtueshmërinë dhe OST përkatëse e konsideron qe objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim, objekti i shpërndarjes i lidhur ne transmetim, ose sistemi i shpërndarjes i lidhur ne transmetim eshte ne pajtueshmëri me kete Rregullore.

Nese OST respektive dhe pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim nuk zgjidhin papajtueshmëritë brenda kornizës kohore te arsyeshme, por ne cdo rast jo me vone se gjashte muaj pas njoftimit te refuzimit te kërkesës per derogim, cdo pale mund ta referoje çështjen per vendim ne autoritetin rregullator .

Neni 26

Njoftimi operacional i kufizuar

1. Pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim te cilit i eshte dhene nje FON, duhet te informoje OST respektive jo me vone se 24 ore pas incidentit te ndoshur, ne rrethanat e meposhtme:

a. Objekti përkohësisht eshte subjekt ose i nje ndryshimi potencial ose humbjes se aftësisë qe prek performancen; ose

b. deshtimi i paisjes qe con ne papajtueshmëri me disa nga kërkesat respektive. Periudhe me e gjate kohe per te informuar OST respektive mund te dakordohet me pronarin e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatorin e sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim ne varësi te natyrës se ndryshimeve.

2. Pronari i objektit te kërkesës ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim duhet te implementojne per OST respektive nje njoftim te kufizimit operativ (LON) , nëse pronari i objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ose operatori i sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim pret që rrethanat e përshkruara në paragrafin 1 të vazhdojnë për më shumë se tre muaj.

3. Nje LON do te lëshohet nga OST respektive dhe do te permbaje informacionin i cili do te jete i identifikueshëm qartësisht mbi :

a. çështjet e pazgjidhura qe justifikojnë dhënien e LON;

b. përgjegjësitë dhe afatet per zgjidhjen e pritshme; dhe

c. kohen maksimale te vlefshmërisë e cila nuk do te kaloje 12 muaj. Periudha fillestare e dhënë mund të jetë më e shkurtër me mundësi vazhdimi, nëse jane paraqitur prova te kënaqshme per OST respektive duke demonstruar se është bërë progres i konsiderueshëm në drejtim të arritjes se pajtueshmërisë së plotë.

4. FON do të pezullohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së LON në lidhje me artikujve për të cilat është lëshuar LON

5. Zgjatje e mëtejshme e periudhës së vlefshmërisë së LON mund të jepet sipas kërkesës për derogim të bërë nga OST respektive para skadimit të kësaj periudhe, në përputhje me procedurën e derogimit të përshkruar në Kapitullin 2 të Titullit V.

6. OST respektive ka të drejtë të refuzojë lejimin e funksionimit të objektit të kërkesës të lidhur në transmetimit, të objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetimit, apo sistemin e shpërndarjes të lidhur në transmetim sapo LON nuk është më i vlefshëm. Në raste të tilla, FON bëhet automatikisht i pavlefshëm.

7. Nëse OST respektive nuk i jep një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së LON në përputhje me paragrafin 5 ose në qoftë se ajo refuzon të lejojë funksionimin e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, të objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, ose sistemi të shpërndarjes të lidhur në transmetim sapo LON nuk është më i vlefshëm në përputhje me paragrafin 6, pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim mund t'ia referojë çështjen për vendim autoritetit rregullator brenda gjashtë muajve pas njoftimit të vendimit të OST përkatëse.

TITULLI III

LIDHJA E NJËSIVE TË KËRKESËS TË PËRDORURA NGA OBJEKTI I KËRKESËS OSE SISTEM I MBYLLUR SHPËRNDARJE PËR TË SIGURUAR SHËRBIME TË PËRGJIGJES SE KËRKESËS PËR OPERATORET E SISTEMIT

KAPITULLI 1

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

Dispozita të përgjithshme

1. Shërbimet e përgjigjes se kërkesës të siguruara për operatorët do të dallohen në baze të kategorive të mëposhtme:

a. të kontrolluara në distancë:

- i. përgjigja e kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë aktive;
- ii. përgjigja e kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë reaktive;
- iii. përgjigja e kërkesës për menaxhimin e kufizimeve në transmetim

- b. te kontrolluara ne menyre te pavarur:
 - i. përgjigja e kërkesës per kontrollin e frekuencës
 - ii. përgjigja e kërkesës per kontroll shume te shpejte te fuqisë active
- 2. Objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura te shpërndarjes mund te sigurojnë shërbime te përgjigjes se kërkesës per operatoret respektiv te sistemit dhe OST-te përkatëse .Kjo rregullore nuk zbatohet ne shërbimet e kërkesës te siguruara per subjektet te ndryshme nga operatori i sistemit ose OST-te respektive.
- 3. Kategorite e përmendura ne paragrafin 1 nuk janë ekskluzive dhe kjo rregullore nuk i pengon kategoritë e tjera per tu zhvilluar. Kjo Rregullore nuk zbatohet ne shërbimet e përgjigjes se kërkesës për subjektet te ndryshme nga operatorët përkatës të sistemit apo OST-te respektive.

Neni 28

Dispozita te veçanta per njesite e kërkesës me përgjigje te kërkesës per kontroll te fuqisë reaktive, kontroll te fuqisë reaktive dhe menaxhimin e kufizimeve ne transmetim

- 1. Objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura te shpërndarjes mund te ofrojnë përgjigje te kërkesës per kontroll te fuqisë aktive, përgjigje te kërkesës per kontroll te fuqisë reaktive, ose përgjigje te kërkesës per menaxhimin e kufizimeve te transmetimit per operatoret e sistemit respektiv dhe OST-te respektive.
- 2. Njesite e kërkesës me përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit te fuqisë aktive, me përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit te fuqisë reaktive, ose përgjigjen e kërkesës kundrejt menaxhimit te kufizimeve ne transmetim do te përmbushin kërkesat e meposhtme, ose individualisht ose kur ajo nuk eshte pjese e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, kolektivisht, si pjese e agregimit te kërkesës nëpërmjet nje pale te trete:
 - a. Te jete ne gjendje te operoje gjate diapazoneve te frekuencës te specifikuar ne Nenin 12(1) dhe diapazonin e zgjeruar te specifikuar ne Nenin 12(2);
 - b. Te jete ne gjendje te operoje gjate diapazoneve te tensionit te specifikuar ne Nenin 13 nese jane te lidhur ne nivelin e tensionit mbi 110kV;
 - c. Te jete ne gjendje te operoje gjate diapazonit normal te operimit te sistemit ne piken e lidhjes, te specifikuar nga operatori i sistemit përkatës, nëse lidhet ne nivelin e tensionit nen 110kV. Ky diapazon duhet te marre parasysh standartet ekzistuese dhe duhet , para aprovimit ne përputhje me Nenin 6, te jete subjekti i konsultimit me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1);

d. Te jete ne gjendje te kontrolloje konsumin e energjisë nga rrjeti ne nivelin e barabarte me ate te kontraktuarin, direkt ose indirekt nëpërmjet nje pale te trete , nga operatori i sistemit ose OST respektive;

e. Te paiset per te marre udhëzime , direkt ose indirekt nëpërmjet palës se trete, nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive per te modifikuar kërkesën e tyre dhe transferoje informacionin e nevojshëm .Sistemi i operatorit respektiv do te beje te disponueshme publikisht specifikimet teknike te miratuara per te mundësuar këtë transferim te informacionit. Per njesite e kërkesës te lidhura ne tension nen 110 kV, keto specifikime duhet para aprovimit ne përputhje me Nenin 6, të jenë subjekt i konsultimeve me palët e interesuara, në përputhje me nenin 9 (1);

f. Te jene ne gjendje te rregullojnë konsumin e energjisë brenda kohës se specifikuar nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive.Per njesite e kërkesës te lidhura ne përputhje me nenin 6, te jene subjekt i konsultimeve me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1);

g. Te jene ne gjendje per ekzekutimin e plote te nje udhëzimi te lëshuar nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive per te modifikuar konsumin e energjisë ne kufinjte e sigurisë se mbrojtjes elektrike, përveç rasteve kur eshte ne fuqi nje metode e dakorduar me operatorin e sistemit respektiv ose OST respektive per zëvendësimin e kontributit te tyre (perfshire kontributin e objekteve te kerkeses te agreguar nëpërmjet nje pale te trete);

h. Pasi eshte bere nje modifikim i konsumit te energjisë dhe per kohëzgjatjen e modifikimit te kërkuar, modifikojmë vetëm kërkesën e përdorur per te siguruar shërbimin nëse kërkohet nga operatori i sistemit respektiv ose OST përkatëse ne kufinjte e sigurisë se mbrojtjes elektrike, përveç nëse ka marrëveshje kontraktuale per metoden me operatorin e sistemit ose OST-ne respektive per zëvendësimin e kontributit te tyre (perfshire kontributin e objekteve te kërkesës te agreguara nëpërmjet nje pale te trete) .Udhëzimet per modifikimin e konsumit te energjisë mund te kene efekt te menjëhershëm ose te vonuar;

i. Njofton operatorin e sistemit respektiv ose OST respektive per modifikimin e kapacitetit te përgjigjes se kërkesës;

j. Kur operatori i sistemit respektiv ose OST respektive, direkt ose indirekt nëpërmjet nje pale te trete, komandon modifikimet e konsumit te energjisë, ben te disponueshme modifikimet e pjesës se tij te kërkesës ne përgjigje te nje udhëzimi te dhene nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive, brenda kufinjve te rene dakord me pronarin e objektit te kërkesës ose CDSO-në ne përputhje me tarimet e njësisë se kërkesës;

k. Ka aftësinë per te përballuar dhe mos u çkycur nga sistemi per shkak te ndryshimit me shkalle te frekuencës deri ne vlerën e specifikuar nga OST respektive. Ne lidhje me kete aftësi per ti bere balle , vlera e shkalles se ndryshimit me hap te frekuencës do te llogaritet mbi 500ms si afat kohor. Per njesite e kereses te lidhura ne nivelin e tensionit poshtë 110

kV, keto specifikime , para aprovimit ne përputhje me Nenin 6, te jenë subjekt i konsultimit me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1)

l. Kur modifikimi në konsumin e energjisë është përcaktuar me anë të kontrollit të frekuencës ose tensionit, ose të te dyjave, dhe nëpërmjet sinjalit te para-alarmit te dërguar nga operatori i sistemit respektiv ose OST përkatëse, të pajiset për të marrë, direkt ose indirekt nëpërmjet një pale të tretë, udhëzimet nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive, për të matur vlerën e frekuences apo të tensionit , ose të dyja, për të komanduar ndaljen e kërkesës dhe për të transferuar informacion. Operatori i sistemit relevant do të specifikojë dhe publikojë specifikimet teknike të miratuara për të mundësuar këtë transferim te informacionit. Për njësitë e kërkesës te lidhura në nivelin e tensionit poshtë 110 kV , para miratimit në përputhje me nenin 6, këto specifikime do të jenë subjekt i konsultimeve me palët respektive në përputhje me nenin 9 (1).

3. Per kontroll te tensionit me ckycje ose kyçje te objekteve statike te kompensimit, cdo objekt kerkese i lidhur ne transmetim ose sistem i mbyllur shpërndarje i lidhur ne transmetim do te jete ne gjendje te kycë ose çkycë objektet statike te kompensimit, direkt ose indirekt , individualisht ose bashkërisht si pjese te agregimit te kërkesës npermjete nje pale te trete, ne përgjigje te nje udhëzimi te transmetuar nga OST respektive dhe pronari i objektit te kërkesës ose CDSO.

Neni 29

Dispozita te veçanta per njesite e kërkesës me përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit te frekuencës se sistemit

1. Objektet e kërkesës ose sistemet e mbyllura te shpërndarjes mund te ofrojnë përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit te frekuencës se sistemit per operatoret respektiv ose OST-te respektive.

2. Njesite e kërkesës me përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit te frekuencës se sistemit do te përmbushin kërkesat e mëposhtme, ose individualisht ose , dhe kur nuk është pjese e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim ,kolektivisht si pjese te agregimit nëpërmjet një pale te trete:

a. Te jene ne gjendje te operojnë gjate shkalleve te frekuencës se specifikuar ne Nenin 12(1) dhe shkalleve te zgjeruara ne Nenin 12(2);

b. Te jete ne gjendje te operoje ne diapazonet e tensionit te specifikuar ne Nenin 13 nëse lidhet ne një nivel tensioni ne ose mbi 110 kV;

c. Te jete ne gjendje te operoje përgjatë diapazonit normal te operimit te sistemit ne piken e lidhjes, te specifikuar nga operatori i sistemit përkatës, nëse lidhet ne nivelin e tensionit poshtë 110 kV.Ky diapazon do te marre parasysht standartet ekzistuese, dhe para

aprovimit ne përputhje me Nenin 6, do te jene subjekt i konsultimit me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1);

d. Te paiset me sistem kontrolli qe eshte i pandjeshëm brenda deadbandes rreth frekuencës nominale te sistemit prej 50 .00Hz, me gjerësi per tu specifikuar nga OST respektive ne konsultim me OST-te ne zonën sinkrone.Per njesite e kërkesës te lidhura ne tension nen 110 kV, keto specifikime para aprovimit ne përputhje me Nenin 6, do te jene subjekt i konsultimit me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1);

e. Te jete ne gjendje , nëpërmjet kthimit te frekuences brenda deadbandes te specifikuar ne paragrafin 2(d), inicioje kohe vonese te rastit prej me shume se 5 minutash para rikthimit ne operim normal.

Devijimi maksimal i frekuencës nga vlera nominale 50.00Hz per tu përgjigjur do te specifikohet nga OST respektive ne koordinim me OST-ne respektive te zonës sinkrone .Per njesite e kërkesës te lidhura ne nivelin e tensionit poshtë 110kV ,keto specifikime do te , para aprovimit ne përputhje me Nenin 6, do te jene subjekt i konsultimit me grupet e interesit ne përputhje me Nenin 9(1);

Kerkesa do te rritet ose zvogëlohet respektivisht per nje frekuencë te sistemi mbi ose nen deadbanden e frekuencës nominale (50.00 Hz);

f. Te paiset me një kontrollues që mat frekuencën aktuale të sistemit. Matjet do të përditësohen së paku çdo 0.2 sekonda;

g. Te jete ne gjendje te të jetë në gjendje të zbulojë një ndryshim në frekuencën e sistemit prej 0.01 Hz, për t'i dhënë përgjigje të përgjithshme lineare proporcionale të sistemit, në lidhje me përgjigjen kërkesës kundrejt kontrollit te frekuencës , ne ndjeshmërisë dhe saktësinë se matjes se frekuencës dhe ndryshimin vijues të kërkesës. Njësia e kërkeses duhet të jetë e aftë të zbuloje shpejt dhe ti përgjigjet ndryshimeve në frekuencen e sistemit, të përcaktuara nga OST përkatëse në koordinim me OST-te në zonën sinkrone. Shmangia e pranueshme në matjet e gjendjes se qëndrueshme të frekuencës do të jetë deri në 0.05 Hz.

Neni 30

Dispozita te veçanta per njesite e kërkesës me përgjigje kundrejt kontrollit shume te shpejte te fuqisë aktive.

1. OST respektive ne koordinim me operatorin e sistemit respektiv mund te dakordoje me pronarin e objektit kërkesës ose nje CDSO(perfshire , por jo kufizuar ne , nëpërmjet nje pale te trete) per kontratën per shpërndarjen e përgjigjes se kërkesës kundrejt kontrollit shume te shpejte te fuqisë aktive.

2. Nëse nje marrëveshje e përmendur ne paragrafin 1 hyn ne fuqi, ajo do te specifikojë:

- a. Ndryshimin e fuqisë aktive në lidhje me masën e tillë si shkalla e ndryshimit me hap e frekuencës për atë pjesë të kërkesës së saj.
- b. Parimet e operimit të këtij sistemi kontrolli dhe parametrave në lidhje me performancën;
- c. Koha e përgjigjes për kontroll shumë të shpejtë të fuqisë aktive, e cila nuk do të jetë më e gjatë se 2 sekonda.

KAPITULLI 2

PROCEDURA E NJOFTIMIT OPERACIONAL

Neni 31

Dispozita të përgjithshme

1. Procedura e njoftimit operacional për njesitë e kërkesës të përdorura nga objektet e kërkesës ose sistemet e mbyllura të shpërndarjes për të siguruar përgjigje të kërkesës për operatorët e sistemit do të dallohet për:
 - a. Njesitë e kërkesës brenda objektit të kërkesës ose sistemit të mbyllur të shpërndarjes të lidhur në nivelin e tensionit ose nën 1000 V;
 - b. Njesitë e kërkesës brenda objektit të kërkesës ose sistemit të mbyllur të shpërndarjes të lidhur në nivelin e tensionit mbi 1000 V.
2. Çdo pronar objekti kërkesë ose CDSO, që siguron përgjigje të kërkesës për operatorin e sistemit respektive ose OST-ne respektive, do të konfirmojë për operatorin e sistemit, ose OST respektive, direkt ose indirekt nëpërmjet një pale të tretë, aftësinë e tij për të kënaqur projektin teknik dhe kërkesat operative të përmendura në Kapitullin 1 të Pjesës III të kësaj Rregulloreje.
3. Pronari i objektit të kërkesës ose CDSO do të njoftojnë, direkt ose indirekt nëpërmjet një pale të tretë, operatorin e sistemit respektiv ose OST-ne respektive, paraprakisht për çdo vendim për të pushuar ofrimin e shërbimit të përgjigjes së kërkesës dhe / ose në lidhje me heqjen e përhershme të njesisë së kërkesës me përgjigje të kërkesës. Ky informacion mund të agregohet siç përcaktohet nga operatori i sistemit përkatës apo OST respektive.
4. Operatori i sistemit respektiv do të përcaktojë dhe bëjë të disponueshme publikisht detajet e mëtejshme në lidhje me procedurën e njoftimit operativ.

Neni 32

Procedurat per njesite e kërkesës brenda nje objekti kerkese ose sistemit te mbyllur shpërndarje te lidhur ne nivelin e tensionit poshtë 1000V.

1. Procedura e njoftimit operacional per njesite e kerkeses brenda nje objekti te kërkesës ose nje sistemi te mbyllur te shpërndarjes te lidhur ne nivelin e tensionit ose poshtë 1000 V do te do te perfshije nje dokument instalimi .
2. Formulari i instalimit do te sigurohet nga operatori i sistemit përkatës dhe përmbajtja do te dakordohet me OST respektive ose direkt ose tërthorazi npermjet nje pale te trete.
3. Bazuar ne nje dokument instalimi , pronari i objektit te kërkesës ose CDSO do te paraqesin informacion, direkt ose tërthorazi nëpërmjet nje pale te trete, per operatorin e sistemit respektiv ose OST respektive.Data e paraqitjes do te jete para ofrimit ne treg tte kapacitetit te përgjigjes se kërkesës nga njësia e kërkesës. Kerkesat e caktuara ne dokumentin e instalimit do te dallojne ndërmjet tipeve te ndryshme te lidhjeve dhe ndërmjet kategorive te ndryshme te shërbimeve te përgjigjes se kërkesës .
4. Per njesite e kërkesës te mëvonshme me përgjigje te kërkesës , do te sigurohen dokumente instalimi te ndara.
5. Permbajtja e dokumentit te instalimit te njësive individuale mund te agregohet nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive.
6. Dokumenti i instalimit do te permbaje pikat e meposhtme:
 - a. Vendodhjen ne te cilën njësia e kërkesës me përgjigje te kërkesës eshte e lidhur me rrjetin;
 - b. Kapacitetin maksimal te instalimeve te përgjigjes se kërkesës ne kW;
 - c. Tipin e shërbimit te përgjigjes se kërkesës ;
 - d. Certifikaten e njësisë se kërkesës dhe te certifikatës se paisjes si te rëndësishme per shërbimin e përgjigjes se kërkesës , ose nëse nuk eshte e disponueshme, informacionin ekujvalent;
 - e. Detajet e kontratës se pronarit te objektit te kërkesës , operatorit te sistemit te mbyllur te shpërndarjes ose te palës se trete qe agregon njesite e kërkesës nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur i shpërndarjes.

Neni 33

Procedurat per njesite e kërkesës brenda objektit te kërkesës ose sistemit te mbyllur te shpërndarjes te lidhur ne nivelin e tensionit mbi 1000 V.

1. Procedura e njoftimit operativ per nje njësi kerkese brenda objektit te kërkesës ose sistemit te mbyllur te shpërndarjes te lidhur ne nivelin e tensionit mbi 1000 V dite perbeje nje DRUD.Operatori i sistemit respektiv , ne koordinim me OST respektive, do te specifikoje përmbajtjen e kërkuar per DRUD. Përmbajtja e e DRUD do te kerkoje deklaraten e pajtueshmërisë e cila përmban informacionin ne Nenin 36 deri 47 per objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura te shpërndarjes, por kërkesat mbi pajtueshmërinë ne nenin 36 deri 47 per objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura te shpërndarjes mund te thjeshtohet nje faze te njoftimit operacional gjithashtu dhe reduktohet. Pronari i objektit te kërkesës ose CDSO mund te ofroje informacionin e kërkuar dhe te paraqesë DRUD te ndara.
2. Bazuar mbi DRUD, operatori i sistemit respektiv do te leshoje nje FON per pronarin e objektit te kërkesës ose CDSO-në.

TITULLI IV

PAJTUESHMERIA

KAPITULLI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 34

Pergjegjesia pronarit te objektit te kërkesës , operatorit te sistemit te shpërndarjes dhe operatorit te te sistemit te mbyllur te shpërndarjes .

1. Pronaret e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim dhe DSO-te do te sigurohen qe objektet e tyre te kërkesës te lidhura ne transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, ose sistemet e shpërndarjes perputhen me kërkesat e siguruara nga kjo Rregullore.Nje pronar objekti kerkese ose nje CDSO qe ofron shërbimin e përgjigjes se kërkesës per operatoret e sistemit respektiv dhe OST-te respektive do te sigurohen qe njësia e kërkesës perputhet me kërkesat per té ne këtë Rregullore.
2. Ku kërkesat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme ne njesite e kërkesës të përdorura nga një objekt i kërkesës ose një sistem i mbyllur i shpërndarjes për të ofruar shërbime të përgjigjes se kërkesës per operatorët përkatës të sistemit dhe OST respektive, pronari objektit te kërkesës ose CDSO-së mundet tërësisht ose pjesërisht tiu delegojë palëve të treta detyra të tilla si komunikimi me operatorin e sistemit përkatës ose OST respektive dhe mbledhjen e dokumentacionit nga pronari i objektit të kërkesës, nga OSHE-ja ose CDSO per evidentimin e pajtueshmërisë.

Palet e treta do te trajtohen si nje përdorues i vetem me të drejtën për të përpiluar dokumentacionin përkatës dhe për të demonstruar përputhshmërinë e objekteve të tyre të kërkesës te agreguara ose sistemet e mbyllura të shpërndarjes te agreguara me dispozitat e kësaj rregulloreje. Objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura shpërndarjes që ofrojnë shërbime të reagimit ndaj kërkesës për operatorët e sistemit përkatës dhe relevant OST-së mund të veprojnë kolektivisht nëpërmjet palëve të treta. Objektet e kërkesës dhe sistemet e shpërndarjes që sigurojnë përgjigje të kërkesës për operatorin respektiv dhe OST respektive mund të veprojnë kolektivisht nëpërmjet nje pale te trete.

3. Ku detyrimet janë përmbushur nëpërmjet palëve të treta, palëve te treta do të tui kërkohet të njoftojnë operatorin përkatës të sistemit për ndryshimet e shërbimeve totale të ofruara, duke marrë parasysh shërbimet specifike të vendodhjes .

4. Kur kërkesat jane specifike nga OST respektive, ose jane për qëllime të operimit të sistemit respektiv të OST-se, teste alternative ose kërkesat për pranimin e rezultateve të testeve mund të dakordohen me OST respektive .

5. Për çdo synim për të modifikuar aftësitë teknike të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemit të shpërndarjes, ose njësisë së kërkesës e cila ka ndikim në pajtueshmërinë me kërkesat e parashikuara në Kapitujt 2 deri 4 të Titullit IV, njoftohet operatori i sistemit përkatës, direkt ose indirekt nëpërmjet një pale të tretë, para se të pasohet nga një modifikim i tillë, brenda afatit të dhënë nga operatori i sistemit përkatës.

6. Çdo incident operacionale ose difekt i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, objekt i shpërndarjes i lidhur në transmetim, sistem shpërndarje ose njësi kërkesës e cila ka ndikim në pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në Kapitujt 2 deri 4 të titullit IV, do të behet me dije operatorit të sistemit respektiv , direkt ose indirekt nëpërmjet nje pale te trete, sa me shpejt të jete e mundur pas ngjarjes se nje incidenti te tille.

7. Çdo skedul testi i planifikuar dhe procedurat për të verifikuar pajtueshmërinë e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemin e shpërndarjes, ose njësi kërkese, me kërkesat e kësaj Rregulloreje, do të behet me dije operatorit të sistemit respektiv brenda periudhës së kohës të specifikuar nga operatori i sistemit respektiv dhe miratohet nga operatori i sistemit përkatës para fillimit të tyre.

8. Operatori i sistemit respektiv mund të marrë pjesë në teste të tilla dhe mund të regjistrojë performancën e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, sistemit të shpërndarjes dhe njësisë së kërkesës .

Neni 35

Detyrat e operatorit te sistemit respektiv.

1. Operatori i sistemit respektiv do te vleresoje pajtueshmërinë e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, sistemi shpërndarje, ose njësie kërkesë, me kërkesat e kësaj rregulloreje gjate gjithë jetëgjatësisë se objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, sistemi shpërndarje ose njësi kërkesë. Pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO do te informohen per rezultatet e këtij vleresimi .

Pajtueshmeria e njësisë se kërkesës te përdorur nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur i shpërndarjes per te siguruar shërbimet e përgjigjes se kërkesës per OST-te respektive, do te vlerësohet bashkërisht nga OST respektive dhe operatorët e sistemit përkatës , dhe nëse zbatohet ne koordinim me palët e treta te përfshira ne agregimin e kërkesës .

2. Operatori i sistemit respektiv do te kete te drejte te kerkoje qe pronari i objektit te kërkesës, DSO ose CDSO te kryeje testet e pajtueshmërisë dhe simulimet ne përputhje me nje plan te përsëritur ose skeme te pergjithshme ose pas cdo difekti, modifikimi ose zëvendësimi te cdo paisje qe mund te kete ndikin ne pajtueshmërinë objektit te kërkesës telidhur ne transmetim, objekti te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, sistemin e shpërndarjes ose njësie kërkesë, me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Pronari i njësisë se kërkesës , DSO ose CDSO do te njoftohet per rezultatet e ketyre testeve dhe simulimeve te pajtueshmërisë .

3. Operatori i sistemit respektiv do te beje te disponueshme publikisht listën e informacionit dhe dokumentave qe do te plotësohen po aq sa dhe kërkesat qe do te permbushen nga pronari i objektit te kërkesës ,DSO, ose CDSO ne kuadër te procesit te pajtueshmërisë .Lista do te mbuloje se paku informacionin, dokumentat dhe kërkesat e mëposhtëme:

a. Gjithë dokumentacionin dhe certifikatat qe do te sigurohen nga pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO;

b. Detaje te te dhenave teknike te kërkuara nga objekti i kërkesës te lidhur ne transmetim, objekti i shpërndarjes i lidhur ne transmetim, sistemi i shpërndarjes, ose njësia e kërkesës me rendesi per lidhjet me rrjetin ose operimin e tij;

c. Kërkesat mbi modelet per studimet e gjendjes se qëndrueshme dhe dinamike te sistemit;

d. Afatet për sigurimin e të dhënave të sistemit të nevojshme për të kryer studimet;

e. Stidimet nga pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO per demonstrimin performancës se gjendjes se qëndrueshme dhe dinamike sipas kerkesave te përcaktuara ne përputhje me Nenin 43,44 dhe 45;

- f. Kushtet dhe procedurat perfshire mundesine per regjistrimin e certifikatave te paisjeve.
- g. Kushtet dhe procedurat per përdorimin e certifikatave respektive te paisjeve te lëshuara nga nje certifikues i autorizuar , nga pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO.
4. Operatori i sistemit respektiv do te beje publike ndarjen e përgjegjësive per pronarin e objektit te kërkesës , DSO dhe CDSO dhe operatorin e sistemit per testet e pajtueshmërisë, simulimet dhe monitorimin.
5. Operatori i Sistemit përkatës mundet plotësisht ose pjesërisht të delegojë kryerjen e monitorimit të pajtueshmërisë tek palët e treta. Në raste të tilla, operatori i sistemit përkatës do të vazhdojë sigurimin e pajtueshmërisë me Nenin 11, duke përfshirë dhe duke hyrë në angazhime konfidencialiteti me pranuesin.
6. Nëse testet e pajtueshmërisë ose simulimet nuk mund te kryhen sic eshte dakorduar ndërmjet operatorit te sistemit respektiv dhe pronarit te objektit te kërkesës, DSO ose CDSO per shkaqe qe i atribuohen operatorit te sistemit respektiv, atëherë operatori i sistemit nuk do te refuzoje ne menyre te paarsyeshme njoftimin operacional te referuar ne Titullin II dhe Titullin III.

KAPITULLI 2

TESTIMI I PAJTUESHMERISE

Neni 36

Dispozita te përbashkëta per testet e pajtueshmërisë

1. Testimi i performancës se objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim ose njësisë se kërkesës me përgjigje te kërkesës per kontrollin e fuqisë aktive, me përgjigje te kërkesës per kontrollin e fuqisë reaktive ose përgjigje te kërkesës per menaxhim te kufizimeve ne transmetim , do te synoje ne demonstrimin përmbushjes se kërkesave te kësaj rregulloreje.
2. Pavarësisht nga kërkesat minimale për testimin e pajtueshmërisë të përcaktuar në këtë rregullore, operatori i sistemit respektiv ka të drejtë të:
- a. Lejoje pronarin e objektit te kërkesës , DSO ose CDSO te kryeje grup testesh alternative, me kusht qe keto teste te jene eficente dhe te mjaftueshme per te demonstruar qe objekti i kërkesës ose sistemi i shpërndarjes eshte në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje; dhe
- b. Kërkon nga pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO te kryeje grup testesh shtese ose alternative ne ato raste kur informacioni i dhene per operatorin e sistemit

respektiv ne lidhje me testimin e pajtueshmërisë sipas dispozitave te Nenit 37 deri 41 nuk eshte i mjaftueshem per te demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje .

3. Pronari i objektit te kërkesës , DSO ose CDSO eshte përgjegjës per kryerjen e testeve ne përputhje me kushtet e përcaktuara ne Kapitullin 2 te Titullit IV. Operatori i sistemit respektiv do të bashkëpunojë dhe nuk do të vonojnë padrejtësisht kryerjen e testeve.

4. Operatori i sistemit përkatës mundet të marrë pjesë në testimin e pajtueshmërisë ose në vend ose nga distanca nga dhoma e kontrollit e operatorit të sistemit. Për këtë qëllim, pronari i objektit te kërkesës , DSO-ja ose CDSO do te sigurojne pajisjet e monitorimit të nevojshme për të regjistruar të gjitha sinjalet dhe matjet përkatëse te testit si dhe të sigurojnë që përfaqësuesit e nevojshmem të pronarit të objektit të kërkesës, DSO-se ose CDSO-se janë në në vend, te disponueshem për të gjithë periudhën e testimit. Sinjalet te specifikuara nga operatori i sistemit përkatës jepen nëse, për testet e selektuara, operatori i sistemit dëshiron të përdorë pajisjet e tij per te regjistruar performancën. Operatori i sistemit përkatës ka lirinë të vendosë në lidhje me pjesëmarrjen e tij.

Neni 37

Testet e pajtueshmërisë per çkycjen dhe rilidhjen e objekteve te shpërndarjes të lidhura në transmetim

1. Objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim duhet te jenë në përputhje me kërkesat për shkycje dhe rikycje të përmendura në nenin 19 dhe do t'i nënshtrohet testeve të mëposhtme të pajtueshmërisë.

2. Ne lidhje me testimin e aftësisë per rilidhje pas nje ckycje te rastit per shkak te shqetësimeve ne rrjet, rilidhja do te arrihet nëpërmjet nje procedure per rilidhje , e preferueshme automatikisht, e autorizuar nga OST respektive.

3. Ne lidhje me testet e risinkronizimit ,do te demonstrohen aftësitë teknike per sinkronizim te objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim .Ky test verifikon tarimet e paisjeve sinlronizuese . Ky test mbulon çështjet e meposhtme: tensionin, frekuencën , diapazonin e këndit te fazës, devijimin e tensionit dhe te frekuencës .

4. Ne lidhje me testet e çkyçjes ne distance, do te demonstrohen aftësitë teknike te objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim per ckycje ne distance ne piken e lidhjes ose pikat nga sistemi i transmetimit kur kërkohet nga OST respektive dhe brenda kohës se specifikuar nga OST respektive.

5. Ne lidhje me testet e çkyçjes se kërkesës ne nen-frekuence, do te demonstrohen aftësitë teknike te objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim per ckyçjen e kërkesës ne nen-frekuence ne nje përçindje te kërkesës qe specifikohet nga OST respektive ne koordinim me OST-te fqinje, ku ato paisjen sic parashikohet ne nenin 19.

6. Ne lidhje me testet e releve te çkycjes se kërkesës ne nen-frekuence, do te demonstrohen aftësitë teknike te objekteve te shpërndarjes te lidhura ne transmetim per tu operuar nga nje paisje AC nominal me te dhena te hyrjes ne përputhje me Nenin 19(1) dhe (2).Ky input do te specifikohet nga OST respektive.

7. Ne lidhje me testet e releve te çkycjes se kërkesës ne nen-frekuence, do te demonstrohen aftësitë teknike te objekteve te shpërndarjes te lidhura ne transmetim per te operuar qe nga nje sinjal hyrës AC nominal ne përputhje me Nenin 19(1) dhe (2).Ky input do te specifikohet nga OST respektive.

8. Nje certifikate e paisjes mund te perdoret ne vend te nje pjese te testit te parashikuar ne paragrafin 1, ne kusht qe ti jete siguruar OST respektive.

Neni 38

Testet e pajtueshmërisë per shkëmbimin e informacionit me objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim

1. Ne lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet OST-se respektive dhe operatorit te sistemit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim , ne kohe reale ose periodikisht, do te demonstrohet aftësia teknike e objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, ne përputhje me standardin e shkëmbimit të informacionit të përcaktuar sipas nenit 18 (3).

2. Nje certifikate paisje mund te perdoret ne vend te nje pjese te testit te parashikuar ne paragrafin 1, ne kushtet kur i eshte siguruar OST respektive me pare .

Neni 39

Testet e pajtueshmërisë per çkycjen dhe rilidhjen e objekteve te kërkesës te lidhura ne transmetim.

1. Objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim do të jenë në përputhje me kërkesat për shkycje dhe rilidhje të përmendura në nenin 19 dhe do t'i nënshtrohet testeve të mëposhtme të pajtueshmërisë.

2. Ne lidhje me testimin e aftësisë per rilidhje pas nje ckycje te rastit per shkak te shqetësimeve ne rrjet, rilidhja do te arrihet nëpërmjet nje procedure per rilidhje , e preferueshme automatikisht, e autorizuar nga OST respektive.

3. Ne lidhje me testin e risinkronizimit , do te demonstrohen aftësitë teknike per sinkronizim te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim .Ky test do te verifikoje tarimet e paisjeve sinkronizuese. Ky test mbulon çështjet e mëposhtme: tensionin, frekuencën , diapazonin e këndit te fazës, devijimin e tensionit dhe te frekuencës .
4. Ne lidhje me testin e çkyçjes ne distance, do te demonstrohen aftësitë teknike te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim per çkyçje ne distance ne piken e lidhjes ose pikat nga sistemi i transmetimit kur kërkohet nga OST respektive dhe brenda kohës se specifikuar nga OST respektive.
5. Ne lidhje me testet e releve te çkyçjes se kërkesës ne nen-frekuence, do te demonstrohen aftësitë teknike te objekteve te kërkesës te lidhura ne transmetim per te operuar nga nje sinjal hyrës AC nominal ne përputhje me Nenin 19(1) dhe (2).Ky input do te specifikohet nga OST respektive.
6. Ne lidhje me testet e çkyçjes se kërkesës nga nentensioni, do te demonstrohen aftësitë teknike te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim per te operuar me nje veprim te vetëm me ane të bllokuesit te rregullatorit te degëzimeve ne nenin 19(3) ne përputhje me Nenin 19(2).
7. Nje certifikate e paisjes mund te perdoret ne vend te nje pjese te testit te parashikuar ne paragrafin 1, ne kusht qe ti jete siguruar OST respektive.

Neni 40

Testimi i pajtueshmërisë per shkëmbimin e informacionit te objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim.

1. Ne lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet OST-se respektive dhe pronarit te objektit te kërkesës lidhur ne transmetim , ne kohe reale ose periodikisht, do te demonstrohet aftësia teknike e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, ne përputhje me standardin e shkëmbimit të informacionit të përcaktuar sipas nenit 18 (3).
2. Nje certifikate paisje mund te perdoret ne vend te nje pjese te testit te parashikuar ne paragrafin 1, ne kushtet kur i eshte siguruar OST respektive me pare .

Neni 41

Testimi i pajtueshmërisë për njesitë e kërkesës me përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë aktive, fuqisë reaktive dhe menaxhimit të kufizimeve në transmetim.

1. Në lidhje me testet e modifikimit të kërkesës :

a. aftësitë teknike të njësive të kërkesës të përdorura nga objekti i kërkesës ose sistemi i mbyllur shpërndarje për të siguruar përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë aktive, përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë reaktive ose përgjigje të kërkesës kundrejt menaxhimit të kufizimeve operacionale për të modifikuar konsumin e energjisë, do të demonstrohen pas marrjes së një udhëzimi nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive brenda diapazonit kohëzgjatjes dhe periudhës së kohës të dakorduar me parë dhe të përcaktuar në përputhje me Nenin 28, ose individualisht ose kolektivisht si pjesë e agregimit të kërkesës nëpërmjet një pale të trete;

b. testi do të kryhet ose nga një udhëzim ose ndryshe, duke simuluar marrjen e një udhëzimi nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive dhe përshtatjen e kërkesës për energji të objektit të kërkesës apo të sistemit të mbyllur të shpërndarjes;

c. testi do të konsiderohet i kaluar, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara nga operatori i sistemit respektiv ose OST përkatëse në përputhje me Nenin 28(2)(d)(f)(g)(h)(k) dhe (l).

d. Një certifikatë paisje mund të përdoret në vend të një pjesë të testit të parashikuar në paragrafin 1, në kushtet kur i është siguruar OST respektive me parë.

2. Në lidhje me testin e çkyçjes ose rilidhjes së objekteve statike të kompensimit :

a. Aftësitë teknike të njësive të kërkesës të përdorura nga pronari i objektit të kërkesës ose operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes për të siguruar përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë aktive, përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit të fuqisë reaktive ose përgjigje të kërkesës kundrejt menaxhimit të kufizimeve në transmetim për të çkyçur ose rilidhur, ose të dyja, objektet statike të kompensimit kur merr një instruksion nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive, në periudhën e kohës të pritshme në përputhje me nenin 28, do të demonstrohen ose individualisht ose kolektivisht si pjesë e agregimit të kërkesës nëpërmjet një pale të trete;

b. testi duhet të kryhet duke simuluar marrjen e një udhëzimi nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive dhe më pas shkyçjen e objektit statik të kompensimit, dhe duke simuluar marrjen e një udhëzimi nga operatori i sistemit përkatës ose OST respektive dhe më pas rilidhjen e objektit;

c. testi do te konsiderohet i kaluar , me kusht që te jene plotësuar kushtet e përcaktuara nga operatori i sistemit përkatës ose OST përkatëse në pajtim me nenin 28 (2) (d) (f) (g) (h) (k) dhe (l) .

KAPITULLI 3

SIMULIMET E PAJTUESHMERISE

Neni 42

Dispozita te perbashketa mbi simulimet e pajtueshmerise

1. Simulimet e performancës se objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim , nje objekti te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, ose njësisë se kërkesës me përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit shume te shpejte te fuqisë aktive brenda nje objekti kërkesë ose sistemi te mbyllur shpërndarje do te rezultojë ne demonstrimin nëse jane përmbushur apo jo kërkesat e kësaj Rregulloreje .

2. Simulimet do te kryhen ne rrethanat e meposhtme:

a. Kërkohet nje lidhje e re me sistemin e transmetimit;

b. Nje njësi e re kerkese e përdorur nga objekti i kërkesës ose sistem i mbyllur i shpërndarjes per te siguruar përgjigje te kërkesës kundrejt kontrollit shume te shpejte te fuqisë aktive per OST respektive ka qene i kontraktuar ne përputhje me Nenin 30;

c. Behen zhvillime te mëtejshme, zëvendësime ose modifikime te paisjes ;

d. Ka papajtueshmëri te supozuara nga operatori i sistemit respektiv me kërkesat e kësaj rregulloreje

3. Pavarësisht nga kërkesat minimale për simulim pajtueshmërisë të përcaktuara në këtë rregullore, operatori i sistemit respektiv ka të drejtë të:

a. lejoje pronarin e objektit te kërkesës, DSO ose CDSO per te kryer grup simulimesh alternative , me kusht qe simulimet te jene eficente dhe te mjaftueshme per te demonstruar qe nje objekt kerkese ose sistem shpërndarje permbush kërkesat e kësaj Rregulloreje ose te legjislacionit kombëtar; dhe

b. Ti kerkoje pronarit te objektit te kërkesës , DSO-se ose CDSO-se te kryeje grup simulimesh alternative ose shtese ne ato raste kur informacioni i dhene per operatorin e sistemit përkatës ne lidhje me simulimet e pajtueshmërisë sipas dispozitave te Neneve 43,44 dhe 45 nuk eshte i mjaftueshem per te demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

4. Pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të ofrojë raport mbi rezultatet e simulimeve për çdo objekt kërkesë të lidhur në transmetim ose objekt shpërndarje të lidhur në transmetim. Pronari i objektit të kërkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të prodhojë dhe ofrojë modele të vlefshme simulimi për një objekt të dhënë kërkesë të lidhur në transmetim ose objekt shpërndarje të lidhur në transmetim. Objektivi i modeleve të simulimit është përcaktuar në Nenin 21(1) dhe (2).

5. Operatori i sistemit respektiv do të ketë të drejtën të kontrollojë nëse objekti i kërkesës ose një sistem shpërndarje pajtohet me kërkesat e kësaj Rregulloreje duke kryer simulimet e veta të pajtueshmërisë bazuar në raportet e siguruar mbi pajtueshmërinë, modelet e simulimit dhe matjet e testit të pajtueshmërisë.

6. Operatori i sistemit përkatës duhet të sigurojë pronarit të objektit kërkesës, DSO-se apo CDSO –se, të dhënat teknike dhe një model simulimi të rrejtë, në masën e nevojshme sa për të kryer simulimet e kërkuara në pajtim me nenet 43, 44 dhe 45.

Neni 43

Simulimet e pajtueshmërisë për objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim

1. Në lidhje me simulimet e aftësisë për fuqi reaktive të objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim:

a. Modeli i simulimit i rrjedhjes së flukseve në gjendje të qëndrueshme të sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të përdoret me qëllim që të llogaritet kërkesa për fuqi reaktive në kushte të ndryshme gjenerimi dhe ngarkese;

b. Pjesë e simulimeve do të jetë kombinimi i kushteve për ngarkese dhe gjenerim minimale dhe maksimale, në gjendje të qëndrueshme që rezultojnë në kërkesën më të lartë dhe më të ulët për fuqi reaktive ;

c. Llogaritja e eksportit të fuqisë reaktive në një fluks të fuqisë aktive me pak se 25% i aftësisë importit maksimal në pikën e lidhjes do të jetë pjesë e simulimeve në përputhje me Nenin 15.

2. OST respektive mund të specifikojë metodën për simulimet e pajtueshmërisë për kontroll të fuqisë aktive dhe reaktive sipas Nenit 15(3).

3. Simulimi do të konsiderohet i kaluar nëse rezultatet demonstronjë pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në Nenin 15.

Neni 44

Simulimet e pajtueshmërisë për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim

1. Në lidhje me simulimin e aftësisë për fuqi reaktive të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim pa gjenerim në ndërfaqe:

a. Objekti i kërkesës i lidhur në transmetim pa gjenerim në ndërfaqe do të demonstrojë aftësinë për fuqi reaktive në pikën e lidhjes;

b. Modeli i simulimit të rrjedhjes së flukseve të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim do të përdoret për të llogaritur kërkesën për fuqi reaktive nën kushte të ndryshme gjenerimi. Kushtet e ngarkesës minimale dhe maksimale që rezultojnë në kërkesë për fuqi reaktive me të lartë dhe me të ultat në pikën e lidhjes do të jenë pjesë e simulimeve;

c. Simulimi do të konsiderohet i kaluar nëse rezultatet demonstrojnë pajtueshmërinë me kërkesat e caktuara në Nenin 15(1) dhe (2).

2. Në lidhje me simulimet e aftësisë për fuqi reaktive të objektit të kërkesës me gjenerim në ndërfaqe:

a. Një model i simulimit të rrjedhjes së flukseve të objektit të kërkesës të lidhur në transmetim do të përdoret për të llogaritur kërkesën për fuqi reaktive nën kushte të ndryshme gjenerimi dhe ngarkese.

b. Kombinimi i kushteve të gjenerimit dhe ngarkesës maksimale dhe minimale që rezultojnë në aftësi për fuqi reaktive në vlerat me të ulëta dhe me të larta në pikën e lidhjes do të jenë pjesë e simulimeve;

c. Simulimi do të konsiderohet i kaluar nëse rezultatet demonstrojnë pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në Nenin 15(1) dhe (2).

Neni 45

Simulimi i pajtueshmërisë për njesitë e kërkesës me përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit shumë të shpejtë të fuqisë aktive.

1. Modeli i njësive të kërkesës të përdorur nga pronari i objektit të kërkesës ose operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes për të siguruar përgjigje të kërkesës kundrejt kontrollit shumë të shpejtë të fuqisë aktive do të demonstrojë aftësitë teknike të njësive të kërkesës për të siguruar kontroll shumë të shpejtë të fuqisë aktive në ngjarjen e nenfrekuenes në kushtet e përcaktuara në Nenin 30.

2. Simulimi do të konsiderohet i kaluar me kusht që modeli të tregojë pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në nenin 30.

KAPITULLI 4

MONITORIMI I PAJTUESHMERISE

Neni 46

Monitorimii pajtueshmërisë per objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim

Ne lidhje me monitorimin e pajtueshmërisë se kerkesave per fuqi reaktive te zbatueshme ne objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim:

- a. Objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim do te paiset me paisjet e nevojshme per te matur fuqinë aktive dhe reaktive përputhje me Nenin 15; dhe
- b. Operatori i sistemit respektiv do te specifikojë kohën per monitorimin e pajtueshmërisë.

Neni 47

Monitorimi i pajtueshmërisë per objektet e kërkesës të lidhura në transmetim

Ne lidhje me monitorimin e pajtueshmërisë te kerkesave per fuqi reaktive te zbatueshme ne objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim:

- a. Objekti i kërkesës i lidhur ne transmetim do te paiset me paisjet e nevojshme per te matur fuqinë aktive dhe reaktive ne përputhje me Nenin 15; dhe
- b. Operatori i sistemit respektiv do te specifikojë kohën per monitorimin e pajtueshmërisë .

TITULLI V

ZBATIMET DHE DEROGIMET

KAPITULLI 1

ANALIZA E KOSTOS

Neni 48

Identifikimi i kostove dhe përfitimeve pas zbatimit te kerkesave ne objektet ekzistuese te kërkesës te lidhur ne transmetim, objektet ekzistuese te

shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njësive ekzistuese të kërkesës .

1. Para zbatimit të çdo kërkesë të përcaktuar në këto rregullore në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njësive ekzistuese të kërkesës në përputhje me Nenin 4(3), OST respektive do të kryejë krahasim cilësor të kostove dhe përfitimeve në lidhje me kërkesat e marra parasysh. Ky krahasim do të marrë parasysh alternativat me baze rrjeti dhe baze tregu. OST respektive mundet vetëm të procedojë për të ndermarre analize të kostove sasiore në përputhje me paragrafin 2 deri 5 , nëse krahasimi cilësor tregon që përfitimet e pritshme tejkalojnë kostot e pritshme. Nëse, megjithatë, kostoja konsiderohet e lartë, ose përfitimi konsiderohet i ulët, atëherë OST respektive nuk do të vazhdojë më tej.
2. Pas fazës përgatitore të ndërmarrë në përputhje me paragrafin 1, OST respektive do të kryejë analizë sasiore të kosto-përfitimit për çdo kërkesë të marre parasysh për tu zbatuar në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njësive ekzistuese të kërkesës që kanë treguar përfitime të mundshme si rezultat i fazës përgatitore, sipas paragrafit 1.
3. Brenda tre muajve të përfundimit të analizës së kosto-përfitimit, OST respektive do të përmbledhë përfundimet në një raport i cili do të:
 - a. Përfshijë analizat e kosto-përfitimit dhe një rekomandim se si të procedohet më tej;
 - b. Përfshijë një propozim për një periudhë kalimtare për zbatimin e kërkesave në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njësive ekzistuese të kërkesës. Kjo periudhë kalimtare nuk duhet të jetë më shumë se dy vjet nga data e vendimit të autoritetit rregullator ose kur është e zbatueshme Palës Kontraktuese për zbatueshmërinë e kërkesës;
 - c. Jete subjekt i konsultimit publik në përputhje me Nenin 9.
4. Jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të konsultimit publik, OST do të përgatisë një raport ku shpjegon rezultatin e konsultimit dhe duke bërë një propozim mbi zbatueshmërinë e kërkesës në shqyrtim, në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njësive ekzistuese të kërkesës . Raporti dhe propozimi i njoftohet autoritetit rregullator ose, kur është e zbatueshme, Palës Kontraktuese, dhe pronarit të objektit të kërkesës, DSO-se, CDSO-se ose, kur është e zbatueshme, palës së tretë duhet të informohet mbi përmbajtjen e saj.
5. Propozimi i bërë nga OST respektive për autoritetin rregullator ose, kur zbatohet Pala Kontraktuese në përputhje me paragrafin 4 do të përfshijë si më poshtë:

a. proceduren e njoftimit operativ per demonstrimin e implementimit te kerkesave nga objektet ekzistuese te kerkeses të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese te shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese te shpërndarjes dhe njesite ekzistuese te kerkesës te përdorura nga nje objekt kerkesese ose sistem i mbyllur shpërndarje per te ofruar shërbimet e përgjigjes se kerkesës per operatoret e sistemit dhe OST-te respektive;

b. peridhen kalimtare per implementimin e kerkesave te cilat do te marrin parasysh klasat e objekteve te kerkesës te lidhur ne transmetim, objektet e shpërndarjes te lidhur ne transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njesite e kerkesës te përdorura nga nje objekt kerkesese ose sistem i mbyllur shpërndarje per te siguruar shërbime te përgjigjes se kerkesës per operatoret e sistemit respektiv dhe OST-te respektive dhe çdo pengesë për zbatimin efikas të modifikimit/riparimit të pajisjeve.

Neni 49

Parimet e analizës se kosto-perfitimit

1. Pronaret e objektit te kerkesës, DSO-te dhe CDSO-te do te asistojnë dhe kontribuojnë ne analizen e koston te ndermarre ne përputhje me Nenin 48 deri 53 dhe sigurojnë te dhënat e nevojshme sic kërkohet nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive brenda tre muajve te marrjes se kerkesës, përveç rasteve kur eshte rene dakord ndryshe nga OST respektive. Per përgatitjen e analizës se kosto-perfitimit nga pronari i objektit te kerkesës ose pronari i ardhshëm , ose nga nje DSO/CDSO ose operator i ardhshëm , duke vlerësuar nje derogim potencial ne përputhje me nenin 52, OST përkatëse dhe DSO do te asistojnë dhe kontribuojnë ne analizat e kosto-përfitimit dhe sigurojnë te dhënat e nevojshme sic kërkohet nga pronari i objektit te kerkesës ose pronari i ardhshëm , ose nga DSO /CDSO ose operatori i ardhshëm , brenda tre muajve pas marrjes se kerkesës, përveç nëse bihet dakord ndryshe nga pronari i objektit te kerkesës ose pronari i ardhshëm, o se nga DSO/CDSO ose operatori i ardhshëm .

2. Analiza e koston do te jete ne linje me parimet e meposhtme:

a. OST respektive, pronari i objektit te kerkesës, DSO/CDSO ose operatori i prespektives, do ta bazojnë analizën e tyre te kosto përfitimit mbi nje ose me shume nga parimet llogaritëse te meposhtme:

- i. vlera aktuale neto;
- ii. kthimi i investimit;
- iii. norma e kthimit
- iv. koha e rentabilitetit

b. OST respektive, pronari i objektit te kërkesës ose pronari i ardhshëm , DSO/CDSO ose operatori i ardhshëm, do të përcaktojnë sasinë e përfitimeve socio-ekonomike në drejtim të përmirësimit të sigurisë së furnizimit dhe do të përfshijë të paktën:

- i. reduktimi që shoqëron probabilitetin e humbjes së furnizimit mbi jetegjatesinë e modifikimit
- ii. shtrirja e mundshme dhe kohezgjatja e humbjes së tille të furnizimit; dhe
- iii. kostoja shoqërore në ore të një humbje të tille të furnizimit;

c. OST respektive, pronari i objektit te kërkesës ose pronari i ardhshëm, DSO/CDSO ose operatori i ardhshëm, do të përcaktojnë sasinë e përfitimeve në tregun e brendshëm të energjisë, shkëmbimin nderkufitar dhe integrimin e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë se paku:

- i. përgjigjen e fuqisë aktive ndaj frekuencës ;
- ii. rezervat balancuese;
- iii. sigurimi i fuqisë reaktive;
- iv. menaxhimi i Konxhestioneve
- v. masat e mbrojtjes;

d. OST respektive do të përcaktojë sasinë e kostove të zbatimit të rregullave të nevojshme në objektet ekzistuese të kërkesës të lidhur në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes, ose njesite e kërkesës, duke përfshirë se paku:

- i. kostot direkte të shkaktuara në implementimin e një kërkesë;
- ii. shpenzimet në lidhje me humbjen që i takon mundësive;
- iii. kostot në lidhje me ndryshimet që rezultojnë nga mirëmbajtja dhe operimi;

KAPITULLI 2

DEROGIMET

Neni 50

Fuqia per te dhene derogime

1. Autoritetet rregullatore munden, me kërkesë të një pronari të objektit te kërkesës ose pronari te ardhshëm, dhe një DSO / CDSO-je ose operatori të ardhshëm, operatori i sistemit respektiv ose OST-je përkatëse , pronareve te objektit te kërkesës ose pronarëve te ardhshëm, dhe DSO-ve / CDSOs ose operatorëve te mundshëm,operatorëve te sistemit apo OST-ve, tiu japë derogim per një ose më shumë prej dispozitave të kësaj Rregulloreje për objektet e reja dhe ekzistuese te kerkeses të lidhura ne transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njësitë e kërkesës në përputhje me nenet 51 deri në 53.
2. Kur është e mundur në një Palë Kontraktuese , përjashtimet mund të jepen dhe të revokohen në pajtim me nenin 51 deri në 53 nga autoritete të tjera nga autoritetit rregullator.

Neni 51

Dispozita te pergjithshme

1. Cdo autoritet rregullator do te specifikojë, kriteret per dhënien e derogimeve ne përputhje me Nenin 52 dhe 53, pas konsultimit me operatoret respektivë te sistemit, pronaret e objektit te kërkesës, DSO-te,CDSO-te dhe grupet e tjera te interesit te cilët i konsideron te prekur nga kjo Rregullore. Ajo do ti publikojë keto kriteret ne faqen e saj te webit,dhe njoftojë Sekretariatit per to brenda 9 muajve te skadimit të afatit të transpozimit te kësaj Rregulloreje. Sekretariati mund te kerkoje nje autoriteti rregullator te amendoje kriterin nëse ai konsiderohet jo ne linje me kete rregullore.Kjo mundësi oer te rishikuar dhe amenduar kriterin per dhënien e derogimeve nuk do te preke derogimet tashme te dhena te cilat do te vazhdojnë te zbatohen deri në datën e caktuar skadimit siç detajohet në vendimin për dhënien e përjashtimit.
2. Nëse autoriteti rregullator e konsideron qe eshte e nevojshme per shkak te ndryshimit ne rrethanat ne lidhje me zhvillimin e kerkesave te sistemit, ai mund te rishikojë dhe amendoje se shumti nje here ne vit kriteret per dhënien e derogimeve ne përputhje me paragrafin 1.Cdo ndryshim ne kriteret nuk do te zbatohet ne derogimet per te cilat eshte bere tashme kërkesë .

3. Autoriteti rregullator mund te vendosi qe objektet e kërkesës te lidhura ne transmetim, objektet e shpërndarjes te lidhura ne transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njesite e kërkesës per te cilat kërkesa per derogim eshte ngritur ne përputhje me Nenin 52 ose 53 , nuk ka nevojë te perputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje sipas se cilës eshte kërkuar nje derogim nga dita e parashtrimit të kërkesës derisa te lëshohet vendimi i autoritetit rregullator .

Neni 52

Kerkesa per derogim nga pronari i objektit te kërkesës , operatori i sistemit te shpërndarjes ose operator i sistemit te mbyllur te shpërndarjes.

1. Pronari i objektit te kërkesës ose pronaret e ardhshëm , dhe DSO-te/CDSO-te ose operoret e ardhshëm , mund te kërkojnë derogim per nje ose disa kërkesa te kësaj Rregulloreje per objektet e kërkesës te lidhur ne transmetim, objektet e shpërndarjes te lidhur ne transmetim, ose njesite e kërkesës te përdorur nga nje objekt kërkesë ose sistem i mbyllur shpërndarje per te siguruar shërbime te përgjigjes se kërkesës per operatorin respektiv dhe OST-ne përkatëse .

2. Kerkesa per derogim do te depozitohet tek operatori i sistemit dhe do te perfshije:

a. Identifikimin e pronarit te objektit te kërkesës ose pronarit te ardhshëm, DSO/CDSO/ne ose operatorin e ardhshëm, dhe nje person kontakti per komunikim;

b. Përshkrimin e objektit te kërkesës te lidhur ne transmetim, objektit te shpërndarjes te lidhur ne transmetim, sistemin e shpërndarjes, ose njësinë e kërkesës per te cilën kërkohet derogim;

c. Nje reference te dispozitave te kësaj rregulloreje sipas se ciles eshte kërkuar derogimi dhe përshkrim te detajuar te derogimit te kërkuar;

d. Arsyet e detajuara, me dokumentet e rëndësishme suprtuese dhe analizat e kosto-perfitimit ne përputhje me kërkesat e Nenit 49;

e. Demonstrimin qe derogimi i kërkuar nuk do te kishte efekt negativ në tregun ndërkufitar.

3. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës për derogim, operatori i sistemit përkatës do ti konfirmojë pronarit të objektit te kërkesës ose pronarit te ardhshëm, ose me DSO / CDSO-se ose operatorit te ardhshëm, nëse kërkesa është e plotë. Nëse operatori i sistemit përkatës e konsideron se kërkesa nuk është e plotë, pronari objektit te kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose DSO / CDSO-ja ose operatori i ardhshëm, duhet të paraqesë informacion shtesë të kërkuar brenda një muaji nga marrja e kërkesës për informacion shtesë. Nëse pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose nëse DSO / CDSO-ja ose operatori

i ardhshëm, nuk do të ofrojë informacionin e kërkuar brenda këtij afati kohor, kërkesa për një shmangie do të konsiderohet e tërhequr.

4. Operatori i sistemit respektiv në koordinim me OST respektive dhe cdo DSO fqinje të prekur, do të vlerësojë kërkesën për derogim dhe sigurojë analizat e kosto-perfitimit duke marrë parasysh kriterin e përcaktuar nga autoriteti rregullator në përputhje me Nenin 51.

5. Brenda gjashtë muajve nga marrja e kërkesës për përjashtim, operatori i sistemit përkatës do t'ia përcjellë kërkesën e autoritetit rregullator dhe të paraqesë vlerësimin (et) e përgatitur(a) në përputhje me paragrafët 4. Ky afat mund të zgjatet nga një muaj ku operatori i sistemit përkatës kërkon informata shtesë nga pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose nga DSO / CDSO –te ose operatori të ardhshëm, dhe në dy muaj, ku operatori i sistemit përkatës kërkon OST përkatëse të paraqesë vlerësimin e kërkesës për një derogim.

6. Autoriteti rregullator do të marrë vendim në lidhje me çdo kërkesë për derogim brenda gjashtë muajve nga dita pas marrjes së kërkesës. Ky afat kohor mund të zgjatet për tre muaj para skadimit të saj, kur autoriteti rregullator kërkon informacion shtesë nga pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose nga DSO / CDSO-ja ose operatori i ardhshëm, ose nga çdo palë tjetër të interesuar. Periudha shtesë fillon kur informacioni i plotë është marrë.

7. Pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose DSO / CDSO –ja ose operatori i ardhshëm, duhet të paraqesë çdo informacion shtesë të kërkuar nga autoriteti rregullator brenda dy muajve të një kërkesë të tillë. Nëse pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose nëse DSO / CDSO-ja ose operatori i ardhshëm, nuk do të ofrojë informacionin e kërkuar brenda këtij afati kohor, kërkesa për derogim do të konsiderohet e tërhequr nëse, para skadimit të saj:

a. Autoriteti rregullator vendos për një shtyrje të afatit;ose

b. Pronari i objektit të kërkesës ose pronari i ardhshëm, ose DSO / CDSO-ja ose operatori i ardhshëm, informon autoritetin rregullator me anë të arsytimit të paraqitur se kërkesa për derogim është e plotë.

8. Autoriteti rregullator do të lëshojë një vendim të arsytuar në lidhje me kërkesën për derogim. Kur autoriteti rregullator jep një derogim, ai do të përcaktojë kohëzgjatjen e tij.

9. Autoriteti rregullator do të njoftojë për vendimin e tij pronarin respektiv të objektit të kërkesës ose pronarin e ardhshëm, DSO / CDSO-ne ose operatorin e ardhshëm, operatorin e sistemit përkatës dhe OST përkatëse.

10. Një autoritet rregullator mund të revokojë vendimin për dhënien e një derogimi nëse rrethanat dhe arsyet themelore nuk vlejnë më, ose mbi një rekomandim të arsytuar të Sekretariatit ose rekomandim të arsytuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë në pajtim me nenin 55 (2).

11. Për njësitë e kërkesës brenda një objekti të kërkesës ose një sistemi të mbyllur të shpërndarjes të lidhur në nivelin e tensionit me pak ose 1000V, kërkesa për derogim në bazë të këtij neni mund të bëhet nga një palë e tretë në emër të pronarit të objektit të kërkesës ose pronarit të ardhshëm, ose në emër të CDSO ose operatorit të ardhshëm. Një kërkesë e tillë mund të jetë për një njësi të vetme të kërkesës apo të disa njësive të kërkesës brenda të njëjtit objekt kërkesë apo të sistemit të mbyllur të shpërndarjes. Në rastin e fundit, dhe me kusht që të specifikohet kapaciteti maksimal kumulativ, pala e tretë mund të zëvendësojë të dhënat e kërkuara nga pika (a) të paragrafit 2 me të dhënat e tyre.

Neni 53

Kërkesa për derogim nga operatori i sistemit respektiv ose OST respektive

1. Operatorët përkatës të sistemit ose OST respektive mund të kërkojnë derogime për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet e shpërndarjes, ose njësitë e kërkesës brenda një objekti kërkesë ose një sistem të mbyllur të shpërndarjes të lidhur ose që do të lidhet me rrjetin e tyre.

2. Operatorët përkatës të sistemit apo OST-të respektive duhet të paraqesin kërkesat e tyre për derogim për autoritetin rregullator. Çdo kërkesë për derogim duhet të përfshijë:

a. Identifikimin e operatorit të sistemit ose OST-se respektive dhe një person kontakti për çdo komunikim;

b. Përshkrimin e objektit të kërkesës të lidhur në transmetim, objektit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, sistemin e shpërndarjes, ose njësinë e kërkesës për të cilën është kërkuar derogimi dhe kapacitetin total të instaluar dhe numrin e objekteve të kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet e shpërndarjes ose njësive të kërkesës ;

c. Kërkesa ose kërkesat e kësaj Rregulloreje për të cilat është kërkuar derogim , me përshkrim të detajuar të derogimit të kërkuar;

d. arsyetimi i detajuar, me të gjitha dokumentet tjera respektive;

e. demonstrimi që derogimi i kërkuar nuk do të kishte efekt negativ në tregun nderkufitar;

f. analizat e kosto-perfitimit në përputhje me kërkesat e Nenit 49. Nëse zbatohet, analizat e kosto-perfitimit do të kryhen në koordinim me OST respektive dhe çdo DSO fqinje.

3. Kur kërkesa për derogim është paraqitur nga DSO përkatëse, autoriteti rregullator, brenda dy javësh nga dita pas pranimit të kërkesës, kërkon nga OST respektive të vlerësojë

kërkesën për derogimi në dritën e kriterëve të përcaktuara nga autoriteti rregullator në përputhje me nenin 51.

4. Brenda dy javësh pas ditës se pranimit të kërkesës për vlerësim, OST respektive do të konfirmojë për DSO respektive nëse kërkesa për derogim është e plotë. Nëse DSO respektive e konsideron se është i paplotë, DSO përkatëse duhet të paraqesë informacionin e kërkuar shtesë brenda një muaji nga marrja e kërkesës për informacion shtesë.

5. Brenda gjashtë muajve pas marrjes së kërkesës për derogim, OST respektive do të dorëzojë tek autoriteti rregullator vlerësimin e saj, duke përfshirë çdo dokumentacion të rendesishëm. Afati kohor prej gjashtë muajsh mund të zgjatet me një muaj kur OST përkatëse kërkon informacion shtesë nga DSO-ja respektive.

6. Autoriteti rregullator do të marrë vendim në lidhje me një kërkesë për derogim brenda gjashtë muajve nga dita pas marrjes së kërkesës. Kur kërkesa për derogim është paraqitur nga DSO-ja respektive, afati kohor prej gjashtë muajsh fillon nga dita e nesërme e marrjes së vlerësimit të OST-së respektive në përputhje me paragrafin 5.

7. Afati kohor prej gjashtë muajsh të përmendur në paragrafin 6 të, para skadimit të saj, mundet të zgjatet për tre muaj, kur autoriteti rregullator kërkon informacion të mëtejshëm nga operatori i sistemit përkatës që kërkon derogim ose nga çdo palë tjetër të interesuar. Kjo periudhë shtesë fillon nga dita pas datës së marrjes së informacionit të plotë. Operatori i sistemit përkatës do të sigurojë çdo informacion shtesë të kërkuar nga autoriteti rregullator brenda dy muajve nga data e kërkesës. Nëse operatori i sistemit përkatës nuk siguron informacionin e kërkuar shtesë brenda këtij afati kohor, kërkesa për derogim do të konsiderohet e tërhequr nëse, para skadimit të afatit kohor:

a. Autoriteti rregullator vendos të japë një zgjatje të afatit; ose

b. operatori i sistemit përkatës informon autoritetin rregullator me anë të arsytimit të paraqitur se kërkesa për derogim është e plotë.

8. Autoriteti rregullator do të lëshojë një vendim të arsyetuar në lidhje me kërkesën për derogim. Kur autoriteti rregullator jep derogimin, ai do të përcaktojë kohëzgjatjen e tij.

9. Autoriteti rregullator do të njoftojë për vendimin e tij operatorin e sistemit përkatës që ka kërkuar derogimin, OST-respektive dhe Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë .

10. Autoritetet rregullative mund të përcaktojnë kërkesa të mëtejshme në lidhje me përgatitjen e kërkesave për derogim nga operatorët përkatës të sistemit. Në këtë mënyrë, autoritetet rregullatore do të marrin në konsideratë përshkrim ndërmjet të sistemit të transmetimit dhe sistemit të shpërndarjes në nivel kombëtar dhe do të këshillohet me operatorët e sistemit, pronarët e objektit të kërkesës dhe palët e interesuara, duke përfshirë prodhuesit.

11. Një autoritet rregullator mund të revokojë vendimin për dhënien e një derogimi nëse rrethanat dhe arsyet themelore nuk vlejné më, ose mbi një rekomandim të arsyetuar të Sekretariatit ose rekomandim të arsyetuar nga Agjencia në pajtim me nenin 55 (2).

Neni 54

Regjistri i derogimeve nga kërkesat e kësaj Rregulloreje

1. Autoritetet rregulative do të mbajnë një regjistër të të gjitha derogimeve që ata kanë dhënë ose refuzuar dhe do t'i sigurojnë Sekretariatit dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë një regjistër të përditësuar dhe të konsoliduar të paktën cdo gjashtë muaj, një kopje e të cilit do të jepet për të ENTSO-E.
2. Regjistri do të përmbaje ne veçanti:
 - a. kërkesën ose kërkesat për të cilat është dhënë ose refuzuar derogimi
 - b. përmbajtjen e derogimit;
 - c. shkakun për dhënien ose refuzimin e derogimit;
 - d. pasojat që rezultojë nga dhënia e derogimit.

Neni 55

Monitorimi i derogimeve

1. Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të monitorojë procedurën e dhënies së derogimit në bashkëpunim me autoritetet rregulative ose autoritetet përkatëse të Palës Kontraktuese . Këto autoritete apo autoritetet përkatëse të palës kontraktuese do të sigurojnë Sekretariatit dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë qëllim.
2. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të lëshojë një rekomandim të arsyetuar për një autoritet rregullator për anulimin e një përjashtimi për shkak të mungesës së arsytimit. Sekretariati mund të lëshojë një rekomandim të arsyetuar për autoritetin rregullator ose organin kompetent të Palës Kontraktuese për të revokuar një shmangie për shkak të mungesës së arsytimit.
3. Sekretariati mund të kërkojë nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë që të raportojë mbi zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 dhe të sigurojë shkaqet për të kërkuar ose jo revokimin e një derogimi.

TITULLI VI

UDHEZIME JO-DETYRUESE DHE MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT

Neni 56.

Udhezime jodetyruese mbi implementimin

1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ENTSO-E do të përgatisë dhe pastaj çdo dy vjet të sigurojë udhëzime jo-detyruese me shkrim të anëtarëve të saj dhe operatorëve të tjerë të sistemit në lidhje me elementet e kësaj rregulloreje që kërkojnë vendime kombëtare. ENTSO-E do të publikojë këtë udhëzim në faqen e saj të webit.
2. ENTSO-E do të konsultohet me grupet e interesit kur përgatit udhëzimet jo-detyruese.
3. Udhëzimi jo-detyrues botuar nga ENTSO për Energji Elektrike shpjegon çështje teknike, kushtet dhe ndërvaresitë të cilat duhet të merren parasysh për permbushjen me kërkesat e kësaj rregulloreje në nivel kombëtar.

Neni 57

Monitorimi

1. ENTSO -E do të monitorojë zbatimin e kësaj rregulloreje, për Palët Kontraktuese, të OST-ve të cilat janë anëtarë të ENTSO-E. Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të monitorojnë zbatimin e kësaj Rregulloreje për Palët Kontraktuese, të cilëve OST nuk janë anëtarë të ENTSO për Energjinë Elektrike, në përputhje me nenin 8 (8) të Rregullores (KE) Nr 714/2009. Monitorimi do të marrë parasysh listën e informacionit përkatës të zhvilluar nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe atë duhet të mbulojë në veçanti çështjet e mëposhtme:
 - a. identifikimin e çdo divergjence në zbatimin kombëtar të kësaj rregulloreje;
 - b. Vlerësimi nëse zgjedhja e vlerave dhe e diapazonit në kërkesat e aplikueshme për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njësitë të kërkesës sipas kësaj Rregulloreje vazhdojnë të jenë të vlefshme.

ENTSO për Energjinë Elektrike do t'i raportojë gjetjet e tij Sekretariatit dhe Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë. Sekretariati dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të vënë në dispozicion të gjeturat që rrjedhin nga monitorimi i zbatimit të kësaj Rregulloreje

2. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me ENTSO-E, do të prodhojë pas 12 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje një listë e informatave relevante për tu komunikuar nga ENTSO –E tek Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë në pajtim me nenin 8 (9) dhe nenin 9 (1) të Rregullores (KE) Nr 714/2009. Lista e informacionit respektiv mund të jetë subjekt i perditimit. ENTSO –E do të mbajë një të plotë, sipas nje formati të standardizuar, arkivë dixhitale të të dhënave të informacionit të kërkuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë.

3. OST përkatëse dueht t'i paraqesin Sekretariatit, Bordi Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO –E informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

Bazuar në kërkesën e autoritetit rregullator, DSO-te do ti sigurojnë OST të dhëna sipas paragrafit 1, përveç nëse informacioni është marrë tashmë nga autoritetet rregullatore, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë apo Sekretariati, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E në lidhje me detyrat e tyre përkatëse të monitorimit zbatimit, me qëllim të shmangies së dyfishimit të informacion.

4. Ku ENTSO-E ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë krijojnë zona që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje, ku, në bazë të zhvillimeve të tregut ose përvojës së mbledhur në zbatim të kësaj Rregulloreje, harmonizimi i mëtejshëm i kërkesave sipas kësaj Rregulloreje është i këshillueshem për të promovuar integrimin e tregut, ata do të propozojnë projekt-amendamentet per kete rregullore në bazë të nenit 7 (1) të Rregullores (KE) Nr 714/2009.

TITULLI VII

Dispozita Finale

Neni 58

Amendimi i kontratave dhe termat e kushtet e pergjithshme

1. Autoritetet rregullative do të sigurojnë që të gjitha dispozitat përkatëse në kontratat dhe kushtet e përgjithshme ne lidhje me lidhjen me rrjetin e transmetimit të objekteve të reja të kërkesës, objekteve të shpërndarjes te reja të lidhura ne transmetim, sistemet e reja të shpërndarjes dhe njësite e reja të kërkesës janë sjelle në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

2. Te gjitha dispozitat përkatëse ne kontratat dhe dispozitat perkatese ne termat dhe kushtet e përgjithshme ne lidhje me lidhjen me rrjetin te objekteve ekzistuese te kerkeses

të lidhura në transmetim, objektet ekzistuese të shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet ekzistuese të shpërndarjes dhe njesite ekzistuese të kërkesës subjekt i një ose disa prej kërkesave të kësaj rregulloreje në përputhje me paragrafi 1 të Nenit 4 do të amendohen me qëllim që të përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje. Pikat përkatëse mund të amendohen brenda tre viteve pas vendimit të autoritetit rregullator të Palës Kontraktuese sic përmendet në Nenin(1).

3. Autoritetet rregullatore duhet të sigurojnë që marrëveshjet ndërmjet operatorëve të sistemit dhe pronarëve të objekteve të reja apo ekzistuese të kërkesës ose operatorët e rinj apo sistemet ekzistuese të shpërndarjes i nënshtrohen kësaj Rregulloreje dhe në lidhje me kërkesat e lidhjes me rrjetin për objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim, sistemet e shpërndarjes dhe njesitë e kërkesës të përdorur nga një objekt i kërkesës ose një sistem i mbyllur i shpërndarjes për të ofruar shërbime të reagimit të kërkesës për operatorët përkatëse të sistemit dhe OST-te respektive, në veçanti në kodet e kombëtare, pasqyrojnë kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 59

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e 20 pas publikimit në fletoren zyrtare të Komunitetit të Energjisë.

Pa rënë ndesh me nenin 4 (2) (b), neni 6, neni 51, neni 56 dhe nenin 57, kërkesat e kësaj rregulloreje do të aplikohen duke filluar tre vjet pas publikimit.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Palët Kontraktuese.

ANEKSI I

Diapazonet e frekuencës dhe periudhat e kohës referuar Nenit 12(1)

Tabela 1

Kjo tabele tregon periudhen minimale te kohes per te cilen objekti i kerkeses i lidhur ne transmetimin dhe objekti i shperndarjes i lidhur ne transmetim ose sistemi i shperndarjes duhet te jete ne gjendje per te operuar ne frekuenca te ndryshme nga frekuenca nominale pa u çkycur nga rrjeti.

Zona sinkrone	Diapazoni frekuences	Periudha e kohës per operim
Europa Kontinentale Ukraina	47.5 Hz – 48.5 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 30 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se koha per 47.5 Hz – 48.5 Hz
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pakufizim
	51.0 Hz – 51.5 Hz	30 minuta
Nordike	47.5 Hz – 48.5 Hz	30 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 30 minuta
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pakufizim
	51.0 Hz – 51.5 Hz	30 minutea
Britania e Madhe	47.0 Hz – 47.5 Hz	20 seconda
	47.5 Hz – 48.5 Hz	90 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 90 minuta
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pakufizim
	51.0 Hz – 51.5 Hz	90 minuta
	51.5 Hz – 52.0 Hz	15 minuta
Irlanda dhe Irlanda e Veriut	47.5 Hz – 48.5 Hz	90 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 90 minuta
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pakufizim
	51.0 Hz – 51.5 Hz	90 minuta

Baltike, Moldavia	47.5 Hz – 48.5 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 30 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se koha per 47.5 Hz – 48.5 Hz
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pakufizim
	51.0 Hz – 51.5 Hz	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 30 minuta
Gjeorgjia	47.0 Hz – 47.5 Hz	20 sekonda
	47.5 Hz – 48.5 Hz	30 minuta
	48.5 Hz – 49.0 Hz	60 minuta
	49.0 Hz – 51.0 Hz	Pa limit
	51.0 Hz – 51.5 Hz	30 minuta

Aneksi II

Diapazonet e tensionit dhe periudhat e kohës te referuara ne Nenin 13(1)

Tabela 2

Tabela tregon afatet minimale te kohes gjatë së cilës një objekt kërkese i lidhur ne transmetim, një objekt i shpërndarjes i lidhur ne transmetim ose një sistem i shpërndarjes i lidhur ne transmetim duhet të jetë i aftë për operim për tensione që devijojnë nga vlera reference 1 pu në pikën e lidhjes pa shkeputur nga rrjeti ku tensioni baze për vlera te pu eshte nga 110 kV deri ne 300 kV.

Zona sinkrone	Diapazoni tensionit	Periudha e kohës per operim
Europa Kontinentale, Ukraina	0.90 pu – 1.118 pu	Pakufizim
	1.118 pu – 1.15 pu	Të specifikohet nga çdo nje TSO, por jo më pak se 20 minuta dhe jo më shumë se 60 minuta
Nordike	0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizim
	1.05 pu – 1.10 pu	60 minuta

Tabela 3

Britania e Madhe	0.90 pu – 1.10 pu	Pakufizim
Irlanda dhe Irland e Veriut	0.90 pu – 1.118 pu	Pakufizim
Baltike, Moldavia	0.90 pu – 1.118 pu	Pakufizim
	1.118 pu – 1.15 pu	20 minuta
Gjeorgjia	0.85 pu – 0.90 pu	30 minuta
	0.90 pu – 1.12 pu	Pa limit
	1.12 pu – 1.15 pu	20 minuta

Tabela tregon afatet minimale te kohës gjatë së cilës një objekt i kërkesës i lidhur ne transmetim, një objekt i shpërndarjes i lidhur ne transmetim ose një sistem i shpërndarjes i lidhur ne transmetim duhet të jetë i aftë te operoje për tensione që devijojnë nga vlera referente 1 pu në pikën e lidhjes pa u shkeputur nga rrjeti, ku tensioni baze për vlerat pu është nga 300 kV deri në 500 kV (përfshirë).

Zona Sinkrone	Diapazoni i tensionit	Periudha e kohës per operim
Europa Kontinentale, Ukraina	0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizim
	1.05 pu – 1.10 pu	Të specifikohet nga çdo OST, por jo më pak se 20 minuta dhe jo më shumë se 60 minuta
Nordike	0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizim
	1.05 pu – 1.10 pu	Të specifikohet nga çdo OST, por jo më pak se 20 minuta dhe jo më shumë se 60 minuta
Britania e Madhe	0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizim
	1.05 pu – 1.10 pu	15 minuta

Irlanda dhe Irlanda e Veriut	0.90 pu – 1.05 pu	Pakufizim
Baltike, Moldavia	0.90 pu – 1.097 pu	Pakufizim
	1.097 pu – 1.15 pu	20 minuta
Gjeorgjia	0.85 pu – 0.90 pu	20 minuta
	0.90 pu – 1.10 pu	Pakufizim
	1.10 pu – 1.15 pu	20 minuta